

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7556 E hënë 11 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Profili Ditës

Nga SPARTAK TOPOLLAJ

Nelson Mandela, një lider mes luftës dhe paqes



Opinion Ditës

Nga VASIL KURETA

Në kushtet kur po ndodhin lëvizje, procese e ndryshime konkrete në zhvillimet botërore, konstatohet një problematikë e mprehtë ekonomike, sociale, politike...

Probleme komplekse në BE, as pesimizëm ekstrem, as optimizëm abstrakt

Pas pak javësh do të mbushen plot 100 vite (saktësisht më 18 korrik), nga dita kur lindi në Mvezo të provincës së Kejpit në Afrikën e Jugut, Nelson Rolihlahla...

Vijon në faqet 10-11

Vijon në faqet 18-19



Durrës/ 40-vjeçarja u masakrua nga burri

Vrasja e gruas, dëshpërimi i të afërmeve: Ç'do të bëhet me 6 fëmijët?

Familjarët: Ana nisi punë në lavanderi, i shoqi s' donte, por djali i doli në krah

DURRËS - Tri ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në qytetin e Durrësit, ku 40-vjeçarja Ardjana Shaholli u vra nga bashkëshorti i saj, të tjera detaje dalin në dritë. Sipas të afërmeve të viktimës, prej një muaji Ana ishte punësuar në një lavanderi në qytetin e Durrësit, por kjo e ka përkeqësuar më shumë raportin me të shoqin...

Në faqen 6

KAMP PER ISH-LUFTETARET NE SIRI E IRAK, VASILI: KRYEMINISTRI GENJEN

RAMA: ISIS NE SHQIPERI? ESHTË FANTAZI E OPOZITES

Kreu i qeverisë: Nuk ka asnjë pretendim nga Europa, lajmet sajesisë. LSI: E konfirmoi kryeministri bullgar në Tiranë, je mashtrues i sëmurë



(Në foto) Kryeministri Edi Rama

Në faqen 3

CEREMONIA

140 vjet nga Lidhja e Prizrenit, Haradinaj: Pajtim me Serbinë, pa pazare

Në faqen 5

TRAFIKU I DROGËS

Kapen 1.5 tonë hashash në Itali, mediat: Gomonia u nis nga Vlora

Në faqen 7

"LIFE PAGES"

Këshillat e mjekes: Si t'i trajtoni aknet në fytyrë, kujdes kozmetikën

Suplement

LISTA E KATERT

10 mijë pronarët në Korçë, shqyrtimi nga ATP dhe procedura për të njohur ecurinë

Në faqet 10-11

Publikohet projekti që u hap rrugën kullave, Arben Derhemi: Godinën e mbrojmë me gjak

Ligj i ri për shembjen e Teatrit, artistët në protestë

Robert Ndrenika: Kryeministri po sillet si Erdogan, përbuz komunitetin e artit

Ndonëse prej muajit shkurt artistët kanë protestuar çdo javë në mënyra të ndryshme për mbrojtjen e godinës së Teatrit Kombëtar dhe mostjetërsimin e truallit të tij, ideja e kahershme e qeverisë tani po vihet në jetë me hapa konkretë. Pas prezantimit nga kryeminis-

Nga FATMIRA NIKOLLI

tri të një projekti që rruhd për së gjeri hapësirën e teatrit, por e bën atë trekatësh përmes një projekti të ri, katër muaj më vonë ato që u komentuan si propozime po vijnë të prezantuara me

hapa ligjorë, paçka se artistët përmes përfaqësish kanë takuar pothuaj gjitha kanet politike duke kërkuar mbështetje. Në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike është publikuar tashmë një projektligj që "rregullon"...

Në faqen 12



ZGJEDHJET DENONCIMI I PD

Urdhri i qeverisë për marrjen e të dhënave personale, ish-presidenti jep alarmin

Nishani: Skenari se si Rama po tenton të manipulojë zgjedhjet vendore 2019

"Bota demokratike duhet ta dënojë këtë praktikë autoritariste"

Ish-presidenti i Republikës, Bujar Nishani, ka ngritur dje alarmin për manipulim të zgjedhjeve të ardhshme vendore. Ai akuzoi qeverinë "Rama" se po përdor shkollat e spitalet për të mbledhur të dhënat e shqiptarëve në funksion të zgjedhjeve të ardhshme. Përmes një reagimi në "Facebook", Nishani tha se zgjedhjet lokale të 2019-ës janë në rrezik. Nishani i referohet një shqetësimi të ngjitur më herët nga opozita për mbledhjen e të dhënave personale të pacientëve në spitale, si dhe ato të prindërve të nxënësve në shkolla. "Qeveria shqiptare urdhëron marrjen e të dhënave personale të shqiptarëve, duke përdorur shkollat dhe spitale. Qëllimi: manipulimi i zgjedhjeve! Një skandal që nuk mund të ndodhë në asnjë vend normal. Bota demokratike duhet ta dënojë këtë praktikë autoritariste. Vepromi tani!", ishte kjo thirrja e ish-presidentit Bujar Nishani. Ndërkohë, prej ditësh opozita e ka denoncuar këtë fakt. Fillimisht, PD përmes deputetes Albana Vokshi denoncoi ministrin e Arsimit, Lindita Nikolla, e cila ka dhënë një urdhër që të gjithë nxënësit të plotësojnë të dhënat personale të prindërve, informacione që sipas tyre do të përdoren për zgjedhjet e ardhshme. Sipas PD-së, formulari i shpërndarë me urdhër të Lindita Nikollës nëpër shkolla është antikushitetues dhe kundër ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Mes të tjerash, PD u bëri thirrje qytetarëve që mos të bien pre e këtyre provokimeve, pasi të dhënat e tyre do të përdoren për shantazhe dhe blerje vote. "Mësuesve u është kërkuar nga ministrja e Arsimit që të marrin sa më shpejt të gjitha të dhënat personale të prindërve për të plotësuar formularin e shpërndarë nga Kryeministria; kartën e identitetit, e-mail, të dhënat personale



Ish-Presidenti i Republikës,
Bujar Nishani

Kreu i grupit parlamentar të PS takon shqiptarët në Romë

Balla me emigrantët: PS do garantojë të drejtën e votës, pavarësisht opozitës

Kryetari i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla u premtoi shqiptarëve që jetojnë e punojnë në Itali se e drejta e votës do të garantohet pavarësisht hezitimit të opozitës. Në këtë takim me emigrantët në Romë, Balla vlerësoi kontributet e tyre për zhvillimin ekonomik të vendit. "E vërteta është se vetëm pas vitit 2013 filloi interesimi i Qeverisë shqiptare për qytetarët që jetojnë jashtë, duke synuar përmirësimin rrënjësor të shërbimit konsullor, hartimin e politikave dhe bashkëpunimin me qeveritë e vendeve ku jetojnë në lidhje me arsimin, kulturën, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, njohtjen e leveve të drejtimit të autom-



jeteve etj. Më në fund pas 25 viteve kemi një ministër në qeveri të dedikuar për çështjen e Diasporës dhe vetëm në 7 muaj kemi miratuar ligjin 'Për diasporën', kemi krijuar agjencinë, por edhe pak ditë më parë Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës", u shpreh Balla.

të të dy prindërve. Prindërit duhet ta plotësojnë sipas urdhrit të paligjshëm të dalë nga zyra e Kryeministrit dhe projekti është mbajtur i fshehtë. Ne dyshojmë se ato të dhëna


do të përdoren në zgjedhje", u shpreh Vokshi ditë më parë. Ndërsa dje ajo denoncoi edhe ministrin e Mirëqenies Sociale e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu që merr të dhënat e pacientëve në

"Ne, Partia Socialiste, jemi të vendosur, pavarësisht hezitimit të partisë kryesore në opozitë, për t'ju garantuar një ndër të drejtat tuaja themelore, atë të votimit dhe vendim-marrjes në politikën e vendit. Natyrisht që garantimi i së drejtës së votës për ju shqiptarët që jetojnë jashtë Shqipërisë paraqet një sërë vështirësish dhe sfidash, por që nuk janë kurrsesi të pakapërcyeshme dhe që zbehen përballë argumenteve në favor të garantimit të votës suaj", tha deputeti i PS-së. Në këtë takim, kryetari i grupit socialist shprehëroi edhe deputeti Jurgis Çyrbja, sekretari i PS-së për Diasporën, Stefan Çipa dhe drejtues të PS-së në Itali.

spitale. Ndërkaq, ajo tregoi një shprehje të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave, për të treguar që Ministria e Shëndetësisë mblodh të dhëna personale në shkelje të ligjit.



Gjatë një mbledhjeje të qeverisë



Teatri me kulla, PD denoncoi Ramën: Bëri projektligj të posaçëm për fituesin

Partia Demokratike denoncoi dje përmes deputetes Albana Vokshi, ato që i ka quajtur veprimet korruptive të kryeministrit Edi Rama, ministrës së Kulturës Mirela Kumbaro dhe kryetarit të Bashkisë Tiranë Erion Veliaj për të shembur Teatrin Kombëtar dhe për ta pushtuar qendrën historike të Tiranës me kullat e sponsorëve, që i mbajnë në pushtet. "Ministria e Kulturës në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë ka publikuar për konsultim projektligjin për përcaktimin e një procedure të veçantë negociimi me kompaninë 'Fusha' sh.p.k. të cilës do t'i jepet falas e gjithë qendra historike e Tiranës, për të shembur Teatrin Kombëtar dhe për të ndërtuar kulla biznesi", u shpreh Vokshi. Sipas saj, projektligji bie ndesh me Kushtetutën dhe ligjin "Për koncesionet dhe Partneritetin Publik-Privat", të ndryshuar, si dhe ligjin "Për vetëqeverisjen vendore". "Ky është një rast i paprecedent! Ndërkohë që ekziston një ligj i posaçëm që rregullon këtë proces për realizimin e një projekti sipas procedurës së Partneritetit Publik-Privat (ligji nr. 125/2013), Rama ka hartuar një ligj tjetër të posaçëm, që rregullon vetëm një rast individual, një projekt konkret, duke synuar shmangien e rregullave të paracaktuara dhe që kanë si synim mbrojtjen e interesit publik. Pra, qëllimi i vetëm është të realizohet një projekt i klientit të Ramës, jashtë çdo procedure që parashikon Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi", tha deputetja e PD-së. "Duke qenë se ka paracaktuar fituesin, Edi Rama nuk mund të kërkojë as konsensusin dhe as të realizojë një procedurë konkurruese ligjore, për këtë arsye propozon ai shkel Kushtetutën, shkel ligjet me këtë projektligj të posaçëm, duke e shndërruar Kuvendin në noter të një marrëveshjeje korruptive dhe klienteliste të tij me një subjekt privat", tha Vokshi.



Kryeministri u sqaron qytetarëve lajmin, pas akuzave të opozitës

Qendër për luftëtarët e ISIS, Rama: Zero e vërtetë, fantazi e opozitës

"Nuk ka pretendime as nga Evropa, as nga Australia"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama i cilësoi të pavërteta lajmet se Shqipëria do të strehojë ish-luftëtarë të ISIS. Kjo temë e hapur prej ditësh në Shqipëri ka sjellë edhe reagimin e qytetarëve në rrjetin social, duke i shkruar vetë kryeministrit në "Facebook". Një qytetar e ka pyetur kryeministrit: "Z.Kryeministër... reagoni më shpejt dhe prerë për gjërat sensitive si kjo që po lakohet ditët e fundit për qendrat e ISIS, mos lejoni të përpunohet opinioni". Ndërsa Rama është përgjigjur: "E kemi sqaruar që është një fantazi e kthyer që në akuzat dhe s'ka asgjë të vërtetë, zero, por tregon se në çfarë katandie është opozita inekzistente e këtij vendi". Rama sqaron më pas se nuk ka një pretendim të tillë as nga Evropa dhe as nga Australia. Ndërkohë, vetë qeveria, përmes një deklaratë për mediat nga këshilltari i Sigurisë në Kryeministri, Sandër Lleshi bëri me dije se nuk ekziston asnjë lloj ideje apo kërkesë për të krijuar një kamp për ish-luftëtarët e ISIS në Shqipëri. Ishte deklarata e kryeministrit bullgar, Boyko Borissov, gjatë një konference për sigurinë në Tiranë pak ditë më parë, e cila solli reagime veçanërisht nga ana e opozitës shqiptare këto ditë. "Këto opinione që i referohen një fraze të përdorur nga kryeministri Borisov janë krejt pa lidhje me subjektin të cilit shefi i qeverisë bullgare iu referua në prononcimin e tij. Është thjesht fjalë për Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, që ishte edhe organizatorja e konferencës ndërkombëtare të para pak ditëve, ku mori pjesë edhe kryeministri i Bullgarisë", thuhej në reagimin e këshilltarit të kryeministrit. Sipas tij, "Shqipëria ka propozuar kthimin e kësaj qendre në një qendër rajonale për të kryer analiza, vlerësime, studime, shkëmbim informacioni si edhe programe të përbashkëta kundër ekstremizmit të dhunshëm". Por kjo qendër as nuk është, as nuk mund të jetë dhe as nuk i ka shkuar kurrkujt në mendje që të kthehet në një repart grumbullimi të ish-militantëve të ISIS-it", u shpreh këshilltari i kryeministrit. Kryeministri i Bullgarisë,



Kryeministri Edi Rama

KRYEMINISTRI BULLGAR

"Egoizmi i disa vendeve europiane duhet të kapërcehet ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor, por sigurisht që këto vende duhet të ketë edhe reforma. Takimi i sotëm tregon pikërisht që Shqipëria bën përpjekje. Unë besoj se duhet të mbështesim këtë qendër për luftën kundër ekstremizmit. Vendi më i bukur i botës është më i varfër dhe më i prapambetur. Elita politike duhet të marrë mësim dhe të punojë më mirë", u shpreh Boyko Borissov.

Boyko Borissov gjatë vizitës në Tiranë javën e kaluar u shpreh se vendet e Ballkanit Perëndimor dhe kryesisht Shqipëria duhet të mbështeten nga vendet e BE. Ai foli për ngritjen e një qendre për luftën kundër ekstremizmit në Tiranë. "Egoizmi i disa

vendeve europiane duhet të kapërcehet ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor, por sigurisht që në këto vende duhet të ketë edhe reforma. Takimi i sotëm tregon pikërisht që Shqipëria bën përpjekje. Unë besoj se duhet të mbështesim këtë qendër për

luftën kundër ekstremizmit. Vendi më i bukur i botës është më i varfër dhe më i prapambetur. Elita politike duhet të marrë mësim dhe të punojë më mirë", u shpreh Boyko Borissov. Ndërsa kryetari i PR, Fatmir Mediu u shpreh se siguria kombëtare nuk ka qenë asnjëherë më e rrezikuar. "Çdo ide për të ngritur një qendër në Shqipëri për rehabilitimin, grumbullimin e Foreign Fighters të ISIS të kthyer nga Siria, apo qendër refugjatësh është një hap shumë i rrezikshëm i pamundur dhe kërcënues për Shqipërinë dhe rajonin. Shë parë, strukturat e sigurisë dhe të rendit në Shqipëri janë të dobëta dhe të korruptueshme. Së dyti, me gjithë arrijtjet e Shërbimeve tona të Inteligjencës, ato akoma nuk janë në nivelin e shërbimeve të vendeve më të zhvilluara", tha Mediu.

SANDËR LLESHI

"Bëhet thjesht fjalë për Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, që ishte edhe organizatorja e konferencës ndërkombëtare të para pak ditëve, ku mori pjesë edhe kryeministri i Bullgarisë. Shqipëria ka propozuar kthimin e kësaj qendre në një qendër rajonale për të kryer analiza, vlerësime, studime, shkëmbim informacioni si edhe programe të përbashkëta kundër ekstremizmit të dhunshëm", tha Lleshi.



Berisha: Deputeti socialist rrefeu ngjarjen e Ramës me dy deputetë të huaj

Ish-kryeministri Sali Berisha tregoi dje një ngjarje, të cilën e cilëson "të denjë si të kish ndodhur në një spital psikiatrik". Ai thotë se gjithçka e ka treguar një deputet socialist. Ai u shpreh se bëhet fjalë për një takim në zyrën e kryeministrit Edi Rama me dy përfaqësues apo deputetë të një vendi mik të BE-së, të cilët janë shokuar, siç thotë Berisha, nga mënyra se si i ka pritur kryeministri. "Të dashur miq, këto ditë vizituan Tiranën dy përfaqësues të rëndësishëm të një vendi mik anëtar i BE. Njëri prej tyre kishte miqësi të kahershme me një deputet socialist. Ky i fundit kishte organizuar takimin me krye, krye, krye Edvinin. Në orën e caktuar ata u paraqitën të shoqëruar edhe nga deputeti socialist në zyrën e piktorit dësh-tak. Por atyre u ndodhi ajo që nuk e kishin imagjinuar. Sapo u ulën, pa iu uruar mirëseardhjen, Edvini me harbutëllëk iu drejtua: 'Perse kemi ardhur? Më thoni mua...'. Të habitur nga pritja, miqtë e huaj panë njëri-tjetrin dhe deputetin që i shoqëronte. 'Mot i nxehtë në Shqipëri', - i përgjigjet njëri prej tyre, i cili gjatë karrierës së tij politike prej tri dekadash kishte takuar dhjetëra e dhjetëra kryeministra. 'Vapë e madhe në Tiranë' - ia ktheu edhe tjetri", vijon historia e treguar nga Berisha. Sipas tij, "ata u shtangën nga përgjigja e Ramës, i cili u tha se: 'Franca më ka dhënë mua Urdhrin e Kavalerit të Legjionit të Nderit, por Franca dhe Makroni janë stupid (të marrë, idiotë) më bllokoi hapjen e negociatave". Këtë histori sipas tij, ia ka rrëfyer një deputet socialist, qytetarit dixhital.

Kreu i grupit të LSI-së kritikon qëndrimet e kreut të qeverisë

Luftëtarët e ISIS, Vasili: Rama e ka gënjeshtren sëmundje pa shërim

Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, ka reaguar pas lajmeve se Shqipëria do të strehojë ish-luftëtarët e kapur robër të ISIS-it, në një kamp të financuar nga vendet e BE. Përmes një postimi në "Facebook", Vasili akuzon Ramën teksa thotë se kryeministri Rama gënjeh kur thotë se nuk do të ketë një kamp të tillë në Shqipëri, pasi një gjë të tillë e konfirmoi kryeministri bullgar gjatë vizitës në Tiranë, që pati pak ditë më parë. "Kryeministri ynë gënjeshtrën e ka sëmundje pa shërim dhe nuk kursen as kryeministritin Borisov. Që kryeministritin ynë e ka gënjeshtrën mënyrë jetese, nuk është lajm. I palodhur,



i paepur dhe pa shërim në sëmundjen e tij të gënjeshtrës, ai në rastin e qendrës së rehabilitimit të ish-të kthyer nga ISIS, nuk kursen as kryeministritin e Bullgarisë, Borissov dhe e nxori atë si njëri që nuk di ç'flet, duke harruar që ai është kryeministri i një vendi anëtar i BE dhe mik i Shqipërisë si Bullgaria", shkroi kreu i grupit

parlamentar të LSI-së. "Meqenëse ky mashtruesi i sëmure kryeministri ynë prapë i ra në qafë opozitës, lexoni vetë se çka thënë z.Borisov, por meqë ky mashtruesi në krye të qeverisë s'ka turp, po ju vëmë në dispozicion edhe videon e konferencës për shtyp që edhe ta shikoni", ka orientuar ndjekësit e tij në "FB". Ndërkohë po dje kritikoi kreun e Kuvendit, Gramoz Ruçi. Në një tjetër status, Vasili shkroi: "Ruçi ligjëron shkatërrimin e parlamentit dhe veten si dispeçer minutash e qehaja dënimesh të deputetëve". Sipas tij, drejtimit i parlamentit ka degraduar si kurrë më parë, pasi kryetari i tij ka ligjëruar dhunim flagrant të rregullores.

SITUATA POLITIKE

INTERVISTA

Tahiri e Xhafaj? Ministri i Jashtëm: Nuk kam parë asnjë dokument që i implikon

Bushati: Koalicioni në 2013-2017 ishte në fije të perit për shkak të "drejtësisë"

"Ndryshimet në qeveri, përgjegjësi ekskluzive e kryeministrit"

Senad Nikshiqi

Ministri i Jashtëm shqiptar, Ditmir Bushati, nga Shkoderë nxori publikisht një fakt që koalicioni PS-LSI ka qenë në rrezik të prishej në mandatin e parë 2013-2017, për shkak të përplasjes për reformën në drejtësi. Edhe pse nuk e përmendi direkt, Bushati tha se ndërkombëtarët ndërhyjnë në atë kohë, sepse PS donte reformën, duke lënë të kuptohet se reforma kundërshtohet nga LSI, që në atë kohë drejtohej nga Ilir Meta, tashmë President i Republikës. Në intervistë ai foli edhe për ish-ministrin Saimir Tahiri, ministrin Xhafaj dhe akuzat ndaj tij, si dhe për marrëveshjen për detin dhe akuzat që i janë bërë personalisht atij nga Shpëtim Idrizi e Sali Berisha.

Moralisht duhet të jetë në detyrë zoti Xhafaj? Tani qëndrimet politike janë qëndrime politike, të cilat janë diametralisht të ndryshme. Kur flasim për implikime duhet të kemi parasysh verifikimin e këtyre akuzave nga institucionet shtetërore. Ajo që ka publikuar PD, pra materiali audio është në duart e prokurorisë. PD pretendon që kemi të bëjmë me veprimtari të jashtëligjshme, ndërkohë që ministri Xhafaj thotë se jemi përballë inskenimit të hapur.

Unë si politikan dhe anëtar të kabinetit dhe për shkak të informacionit që posedoj, besoj versionin e ministrit të Brendshëm. Por nuk ka rëndësi se çfarë besoj unë, apo anëtarët e PD, duhet të flasin institucionet.

Ka një vendim nga institucionet italiane për vëllain e Xhafajit...

Kjo është një histori që nuk ka lidhje me aktivitetin e ministrit Xhafaj.

Lidhje s'ka, po a është normale?

Kjo është një histori që ka ndodhur shumë vite më parë, kur Xhafaj nuk ka qenë ministër i Brendshëm dhe nuk ka përgjegjësi për vëllain. Ndërkohë që historia që ka bërë publike PD, nëse do të rezultonte e



Ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati

vërtetë, qëndrimi i PS ishte i qartë. Dhe kjo është arsyeja që ne gjithashtu jemi më të interesuar se kushdo tjetër që prokuroria shqiptare dhe institucionet ndërkombëtare që asistojnë Shqipërinë t'i shkojnë çështjes deri në fund.

Prokurorinë po e akuzon opozita...

Janë akuzat të drejtpërdrejta... Unë kam dëgjuar opozitën që ka akuzuar trupin diplomatik në Shqipëri. Unë personalisht kurë nuk kam menduar se trupi diplomatik të jetë përcaktues për zhvillimet në vend. Opozita ka bërë akuzat të rënda për Juncker, Mongerinin, për ish-ministrin e Jashtëm gjerman dhe për shumë të

tjerë.

Për reformën në drejtësi faktori ndërkombëtar ju mori përdore...

Kjo nuk është e vërtetë. Personalisht kam qenë një nga njerëzit që kam dhënë kontributin politik në 2013-ën dhe reforma në drejtësi ka qenë në axhendën tonë. Dhe për shkak të funksionit që mbaj, gjëria dhe thellësia e reformës ka qenë insistim i kryeministrit Rama.

Sikurse mund të them se koalicioni ynë i mandati 2013-2017 ishte "në fije të perit" për shkak të përplasjes që ekzistonte për reformën në drejtësi. Roli i faktorit ndërkombëtar për hir të vërtetës ka qenë vendimtar. Ajo që unë them është se tru-

pi diplomatik dhe përfaqësuesit e tij janë të nderuar për punën që bëjnë në Shqipëri. Nuk është mirë nga ana jonë që t'i bëjmë pjesë të procesit.

A jeni tani në fije të perit, nëse marrim shembull nëse largohet zoti Xhafaj, a do të kemi zgjedhje të parakohshme, sepse bëhet fjalë për dy ministra të Brendshëm?

Saimir Tahiri nuk u largua nga ministër për akuzat. Ai u largua tre muaj para zgjedhjeve të vitit të kaluar, së bashku me tre ministra të tjerë. Çështja e tij filloi kur ishte deputet. Tahiri nuk iku për akuzat. Ai u zëvendësua nga Xhafaj, sepse kryeministri, që me Kushtetutë ka ekskluzivitetin e përbërjes së kabinetit vendosi ndryshime në qeveri. Nuk ka qenë as pjesë e paktit me opozitën, sepse në atë kohë ka qenë largimi i disa ministrave, por fakti politik është që akuzat ka filluar për një periudhë të caktuar për kohën kur ka qenë. Në horizont zgjedhjet e parakohshme shfaqen në dy raste: nëse mazhoranca humbet numrat në parlament apo nëse mazhoranca kërkon të verifikojë përgjeshmërinë e saj në publik. Unë nuk flas dot për implikim të dy ministrave dhe



MARRËVESHJA E DETIT

"Kam dëgjuar Bashën që ka thënë se nëse marrim 1 km më shumë nga marrëveshja e 2009-ës, ne do t'i duartrokasim, sikurse kam dëgjuar Berishën që thotë nuk miratohet kjo marrëveshje. Ne jemi duke diskutuar teknikisht. Kontributi më i mirë është të sillmi me seriozitetin dhe maturinë e përgjegjshmërinë që kërkon ky proces, i cili nuk është i lehtë", tha Bushati.

duhet të jem i kujdesshëm në këtë proces. Deri më sot s'kam parë asnjë dokument të implikojë këta persona. Njëri është qytetar i lirë, shpresoj me këtë veprim është vendosur një precedent për të ardhmen. Në rastin tjetër ka një akuzë ndaj vëllait dhe është në hetim.

Zoti Rama ka paralajmëruar ndryshime, me gjasa në shtator...

Kjo është një çështje ekskluzive e kryeministrit. Analizat e brendshme janë të brendshme dhe jo e opinionit publik. Përballë kryeministrit punën tonë të përbashkët e mbrojmë, por edhe njëherë e them çdo lloj ndryshimi në qeveri, është përgjegjësi ekskluzive e kryeministrit.

Po përfillet çdo ditë më shumë se do të ketë kalime deputetësh nga LSI të PS...

Nuk jam në dijeni të këtyre përfaqësuesve. Ka pasur votime pro dhe ka pas shprehje nga deputetët e LSI. Një rast ishte çështje e mosdjes së mandatit dhe një rast tjetër për një votim.

Zoti Idrizi dhe Berisha ju kanë akuzuar për marrëveshjen e detit?

Nëse zgjedhjet janë nga studio apo kongreset e partive është zgjedhja e tyre. Ka kohë që zoti Idrizi është në një galaksi tjetër nga ajo që ne diskutojmë dhe nga ajo për të cilën ne përipiqemi të punojmë. Sa i përket dosjes sonë me Greqinë, me modesti e them se është qeveria e parë në historinë e Shqipërisë që e ka vendosur

në tryezën e punës. Dhe janë hedhur hapa përpara, goftë nga pranimi nga Tsipras dhe Kotzias të ekzistencës së ligjit të luftës si relিকে e të kaluarës dhe Shpëtim Idrizi s'është ta harrojë këtë e çështje që kanë lidhje me përcaktimin e zonës ekskluzive ekonomike dhe shelit detar dhe pjesës së regjimit tokësor. Sepse nëse para disa vitesh ishte e pamundur të perceptohej të uleshe me Greqinë për këtë proces, sot po ulemi të diskutojmë për një marrëveshje të re. Marrëveshja që na la Berisha është relিকে e së shkuarës dhe nuk besoj se ka njeri që mendon se ne u ulëm me Greqinë pas kaq e kaq vitesh për të bërë një marrëveshje të keqe.

Nuk dua t'u hyj basteve që kanë vendosur. Kam dëgjuar Bashën që ka thënë se nëse marrim 1 km më shumë nga marrëveshja e 2009-ës, ne do t'i duartrokasim, sikurse kam dëgjuar Berishën që thotë nuk miratohet kjo marrëveshje. Ne jemi duke diskutuar teknikisht. Kontributi më i mirë është të sillmi me seriozitetin dhe maturinë e përgjegjshmërinë që kërkon ky proces, i cili nuk është i lehtë. Mes fqinjëve ka gjithmonë dallime, por nuk mund të mbetemi peng i këtyre dallimeve. Është detyrë jonë të shohim nga e ardhmja dhe menjoh se qeveritë tona kanë bërë përpjekje të lavdërsueshme dhe është koha që ne këto përpjekje t'i finalizojmë.

Ngjela: Negociatat e Shqipërisë me BE hapen më 28 qershor prej SHBA-ve

Avokati Spartak Ngje la tha dje se hapja e negociatave të Shqipërisë me BE-në më 28 qershor është një gjë e sigurt. Në një koment të publikuar në "Facebook", Ngjela sqaroi arsyen politike që garanton hapjen e negociatave, që sipas tij është te politika aktuale amerikane. "Çelja e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian më 28 qershor është një gjë e sigurt. Cila është arsyeja politike që e garanton hapjen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian? Kurrë nuk duhet mend-



uar se garancia që të gjitha vendet e Bashkimit Evropian do të votojnë për Shqipërinë më 28 qershor do të gjendet në situatën e brendshme të Shqipërisë. Në këtë rast, kjo nuk ka lidhje fare me këtë situatë", shkroi

dje Ngjela. Sipas tij, "garancia që të gjitha vendet e Bashkimit Evropian në mënyrë unanime do të votojnë më 28 qershor për çeljen e negociatave me Shqipërinë është te politika aktuale amerikane për Ballkanin Perëndimor, prandaj vota e tyre politikisht nuk do të hidhet pro apo kundër Shqipërisë. Kështu siç ka ardhur situata, vota e të gjitha vendeve të Bashkimit Evropian për çeljen e negociatave me Shqipërinë, politikisht, kuptohet që do të jetë një votë pro ose kundër Shteteve të Bashkuara Amerikës".



Drejtues të Shqipërisë e Kosovës u mblodhën dje në Kompleksin Monumental në Prizren

140-vjetori i Lidhjes së Prizrenit, Meta: Mesazhi i saj, aktual edhe sot

Haradinaj: Pajtim me Serbinë, pa pazare të ndyra

Darina Tanushi

Drejtues të të dyja shteteve shqiptare, Shqipërisë dhe Kosovës kremtuan dje 140-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit. I pranishëm në Kompleksin Monumental të Lidhjes së Prizrenit, Presidenti i Republikës, Ilir Meta, e cilësoi këtë një ngjarje lapidare. Së bashku me Kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj dhe Rifat Jasharin, në prani të deputetëve e përfaqësuesve të qeverisë së Republikës së Kosovës, akademikëve, historianëve, pasardhësve të pjesëmarrësve të Lidhjes së Prizrenit, krerëve të bashkësive fetare, ish-luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës etj. Presidenti Meta fillimisht mori pjesë dhe përuroi gurthemelin e kompozicionit të shtatoreve të udhëheqësve të Lidhjes së Prizrenit: Ymer Prizreni, Abdyl Frashëri dhe më tej Presidenti Meta e kryeministri Haradinaj vizituan ekspozitën e hapur me këtë rast në Kompleksin Memorial të Lidhjes. "Krijimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte vazhdim i Lidhjes së Lezhës, të krijuar nga Gjergj Kastrioti Skënderbeu shekuj më parë dhe shënonte në vetvete një kulminacion të rizgjidimit dhe të Rilindjes Kombëtare Shqiptare për të shpalosur identitetin kombëtar dhe politik të kombit tonë, për të legjitimuar aspiratat e tij për shtetformim dhe për t'ia bërë ato të ditura të gjithë botës", tha në fjalën e tij Presidenti Meta. Ai u shpreh se "Lidhja Shqiptare e Prizrenit shkaktoi një jehonë të madhe në qarqet politike të vendeve fqinje, por edhe të Fuqive më të mëdha të kohës". "Në historinë e popullit shqiptar sa më shumë kohë do të kalonte, aq më shumë do të lartësohej Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe do të kuptohej mesazhi i saj frymëzues përgjithmonë", vijoi më tej presidenti. "Lidhja Shqiptare e Prizrenit qëndron edhe sot e gjithë ditën në përpjekjet e mëdha të mbarë shqiptarëve për të zgjeruar hapësirat e



EDI RAMA

"Përkujtojmë 140-vjetorin e themelimit të Lidhjes shqiptare të Prizrenit, mesazhi i së cilës kumbon i thjeshtë por domethënës, dje, sot e përgjithmonë: asnjëherë virtyti dhe aq më pak fati e kanë braktisur një Shqipëri të përbashkuar. Kjo ditë na kujton gjithashtu se po i afrohem fundit të gjysmës së parë të Vitit të Skënderbeut, arritjet pa zurmë dhe eventet unike të të cilët po zhvillohen anembanë kombit shqiptar në trojet e tij stërgjyshore dhe në diasporë", shkroi dje Rama në "FB".



INCIDENTI

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj u përfishi dje në një incident gjatë përkujtimit të 140-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit. Ishte pasardhësja e ministrit të Luftës në qeverinë e Ismail Qemalit, gjeneral Mehmet Derralles, e cila doli në foltore pa ftesë gjatë akademisë solemne të shënimit të Lidhjes së Prizrenit, që nxiti kryeministrin Haradinaj të reagojë dhe t'ia ndërpresë fjalimin, siç raportojnë mediat kosovare.



RAMUSH HARADINAJ

Kryeministri i Kosovës foli dje për pazare sa u përket tentativave për vendosjen e marrëdhënieve normale mes Kosovës dhe Serbisë. "Edhe sot i kemi marrëdhëniet e ndjeshme. Një marrëdhënie e pambyllur Kosovë-Serbi po synohet që të kthehet në pazare të reja politike. Është e padrejtë që të ndodhë. Ju siguroj se mënyra e vetme që të përmbillet lufta e '99-ës është me një pajtim mes shqiptarëve dhe serbëve, me njohje mes Kosovës dhe Serbisë pa pazare të tjera të ndyra në dem të shqiptarëve", tha ai.



tyre të lirisë, demokracisë dhe integritimit evropian dhe Euro-Atlantik. Si e tillë, ajo nuk është një relike historike, por është edhe sot një vepër e gjallë frymëzuese për të gjithë ne dhe për të gjitha kohërat", theksoi Presidenti Meta. "Prandaj sot - vijoi ai - përkulemi me ndjenjë të jashtëzakonshme të respektit dhe mirënjohjes për Abdyl Frashërin, për Ymer Prizre-

nin, për Sulejman Vokshin e gjithë ata burra të mençur e atdhetarë, të cilët sakrificuan gjithçka pikërisht për të ardhmen e Shqipërisë, Kosovës dhe mbarë kombit tonë. Sot përkulemi me respekt të jashtëzakonshëm edhe përpara sakrificave të Adem Jasharit dhe të të gjithë heronjve të Kosovës, që janë në themel të këtyre arritjeve që Kosova ka shënuar gjatë 10 viteve të pavarësisë së saj". Ndërsa, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj duke folur për Kosovën e raportet me Serbinë tha: "Edhe sot i kemi marrëdhëniet e ndjeshme. Një marrëdhënie e pambyllur Kosovë-Serbi po synohet që të kthehet në pazare të reja politike. Është e padrejtë që të ndodhë. Ju siguroj se mënyra

e vetme që të përmbillet lufta e '99-ës është me një pajtim mes shqiptarëve dhe serbëve, me njohje mes Kosovës dhe Serbisë pa pazare të tjera të ndyra në dem të shqiptarëve". Ndërsa për Kadri Veselin, kryetar i Kuvendit të Kosovës, pa Lidhjen e Prizrenit nuk do të kishte pavarësi të Shqipërisë dhe Kosovës. "Pa Lidhjen e Prizrenit, nuk do të kishte lëvizjen kombëtare për çlirimin e Kosovës, e cila arriti kulminacionin historik me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, çlirimin dhe shpalljen e pavarësisë në shkurtin e vitit 2008. Pa Lidhjen e Prizrenit, rrjedha e historisë sonë kombëtare do të ishte krejtësisht ndryshe dhe aspak pozitive për kombin tonë", tha Veseli.

TURI NË KLOS

Statusi i minorit, Xhaçka: Drafti përfundimtar do t'u kthehet konsultimeve

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka vijoi turin e llogaridhënies në Bashkinë Klosit dhe njësitë administrative Gurrë e Suç të qarkut të Dibrës. Në këto takime ministria Xhaçka u tha qytetarëve se arsyeja e ballafaqimit me ta nuk është as të bëjë propagandë politike apo propagandë suksesesh, por kjo qeveri ka nevojë të kuptojë se çfarë duhet të bëjë më mirë. "Këto takime janë mundësia që ju të na thoni se çfarë nuk po bëjmë siç duhet. Si po sillmi në përkundërit shërbimeve që duhet t'ju afrojmë? Si po sillen zyrat tona të shtetit? Sa arrini të zgjidhni problemet? Kush ju ka zvarritur? Pse ju ka zvarritur? A arrini të gjeni të drejtën tuaj sa herë trokisini? A ua qajnë hallin edhe kur nuk kanë mundësi t'ua zgjidhin? A bëjnë çmos që t'ju shërbejnë ashtu siç duhet të shërbejë një nëpunës i shtetit, një përfaqësues i yni në zyrat e shtetit? Përfaqësuesi ynë jo i partisë! Të gjitha këto janë gjëra që kryeministri i ka me shumë merak. Kjo qeveri i ka me shumë merak, për të bërë maksimumin për të çrënësuar atë sistemin e vjetër, ku gjërat funksiononin vetëm me taraf, me miqësi me rryshfet", u shpreh ministria Xhaçka. Në këto takime, ministria e Mbrojtjes shoqërohej nga zvmministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Artan Shkrel. Një çështje e ndjeshme e banorëve të Klosit ishte ajo e statusit të minorit, për të cilin ministria Xhaçka garanoi se shumë shpejt do të ketë zgjidhje përfundimtare. "Çështja e statusit të minoritit nuk ka pasur asnjëherë mungesë vullneti nga ana jonë. Kemi qenë gjithmonë ne, që e kemi adresuar problematikën e minoritëve si kategori. Sot kjo çështje ka hyrë në rrugë të mbarë. Po diskutohet, po shqyrtohet dhe shumë shpejt do të dalim me një draft, që sërisht do t'i hyjë një konsultimi publik për të marrë edhe dakordësinë tuaj", u shpreh ministria. Zvmministri Artan Shkrel u shpreh kjo është çështje javësh.



NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA NR. 8/58 + 1 - 4, E LLOJIT 'APARTAMENT', VOLUMI 3, FAQJE 188, ZONA KADASTRALE 8370, ME SIPERFAQJE 75 M2, NË ADRESËN: RRUGA 'TH ZIKO, PALLATI 65/3, TIRANË, NË PRONËSI TË SHTETASVE : Z. ENGJELL TOPORE DHE ZNJ. NATASHA TOPORE".
ÇMIMI 36.350 Euro. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 04.06.2018 deri në datën 04.07.2018.
CEL. 0684026666 ; 0693262866.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA NR. 101 / 8, E LLOJIT 'TRUALL + NDËRTESË', VOLUMI 8, FAQJE 115, ZONA KADASTRALE 3096, ME SIPERFAQJE 3.200 M2, NGA TË CILAT 166 M² ËSHTË NDËRTESA, NË ADRESËN : QERREKË-KRUJE, NË PRONËSI TË SHTETASVE : Z. YAHIA FARWATI dhe BRËXHILDA FARWATI".
ÇMIMI 114.508 Euro. Data e zhvillimit të ankandit do jetë në datën 04.07.2018.
CEL. 0684026666 ; 0693262866.

Burim Pushkollli premtonte punësim kundrejt përfitimeve monetare

Denoncohet nga e dashura në Elbasan për dhunë, zbulohet mashtruesi nga Kosova

Një 36-vjeçar nga Kosova ka rënë në prangat e policisë, pas denoncimit të së dashurës së tij për dhunë fizike dhe psikologjike. Pasi nisi verifikimet, policia e Elbasanit kuptoi se kishte rënë në gjurmët e supermashtruesit nga Kosova. Bëhet fjalë për shtetasin Burim Pushkollli, i cili rezultoi i dënuar në Kosovë, pasi i kishte marrë para tre qytetarëve duke u premtuar punë. "Arrestimi i tij u krye sepse ndaj tij ka bërë kallëzim penal shtetasja S.P., 39 vjeçe, banuese Elbasan, se shtetasi Burim Pushkollli ka ushtruar dhunë psikologjike dhe fizike në mënyrë të vazhdueshme ndaj saj, pasi bashkëjetonte me këtë shtetas", thuhet në njoftimin e policisë. Mësohet se 36-vjeçari ishte fshehur në Elbasan, ku sipas policisë kishte mashtruar edhe dy qytetarë shqiptarë. Mësohet se nga veprimet e para hetimore ka rezultuar se shtetasi Burim Pushkollli nëpërmjet shpërdorimit të

ARRESTIMI

"Arrestimi i Burim Pushkollit u krye sepse ndaj tij ka bërë kallëzim penal shtetasja S.P., 39 vjeçe, banuese Elbasan, se shtetasi Burim Pushkollli ka ushtruar dhunë psikologjike dhe fizike në mënyrë të vazhdueshme ndaj saj, pasi kjo bashkëjetonte me këtë shtetas", thuhet në njoftimin e policisë.



Burim Pushkollli

ifkimet e bëra me Policinë e Kosovës, ka rezultuar se për këtë shtetas ka urdhër arresti për tri vepra penale për mashtrim. Nga ana jonë është komunikuar me Zyrën Interpol Tirana për kryerjen e verifikimeve të mëtejshme për këtë shtetas", thuhet më tej në njoftimin e policisë. Pas sinjalizimeve dhe provave të mbledhura, policia arriti ta ndalonte në Vorë. Materialet hetimore i kaluan Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për veprën penale të "Dhunës në Familje" dhe "Mashtrimit".

S.P., 39 vjeçe, banuese Elbasan, se shtetasi Burim Pushkollli ka ushtruar dhunë psikologjike dhe fizike në mënyrë të vazhdueshme ndaj saj, pasi bashkëjetonte me këtë shtetas", thuhet në njoftimin e policisë. Mëso-

het se 36-vjeçari ishte fshehur në Elbasan, ku sipas policisë kishte mashtruar edhe dy qytetarë shqiptarë. Mësohet se nga veprimet e para hetimore ka rezultuar se shtetasi Burim Pushkollli nëpërmjet shpërdorimit të

besimit i ka marrë një sasi prej 100.000 mijë lekësh shtetasi F.M., 47 vjeç, banues në Elbasan duke i premtuar se do e ndihmonte të regjistronte djalin në Akademinë e Sigurisë në Tiranë. Gjithashtu, rezultoi se shtetas i

mësipërm i ka marrë duke shpërdoruar besimin një sasi prej 50.000 mijë lekësh edhe shtetasit N.L., 32 vjeç, banues në Elbasan, të cilit i ka premtuar se do e fuste në punë në Aeroportin "Nënë Tereza" në Tiranë. "Nga ver-

DURRËS

Ceremonia mortore, tre të miturit nuk i thanë dot lamtumirë nënës së tyre

Tri ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në qytetin e Durrësit, ku 40-vjeçarja Ardjana Shaholli u vra nga bashkëshorti i saj, të tjera detaje dalin në dritë. Sipas të afërmeve të viktimës, prej një muaji Ana ishte punësuar në një lavanderi në qytetin e Durrësit, por kjo e ka përqendruar më shumë raportin me të shoqin. Të afërmit bëjnë me dije se fakti që djali i madh i 40-vjeçares ishte rritur, i kish dhënë guximin të dilte në punë. Pavarësisht se e kish denoncuar disa herë, Çlirim Shaholli shoqërohej e më pas lihej i lirë nga policia që të vazhdonte avazin e vjetër. "Ishte Ana ajo që ka bërë të pamundurën që familja të mbetej e bashkuar", - thotë njëri prej të afërmeve. Pas tragjedisë së ndodhur, ende nuk dihet cili do jetë fati i gjashtë fëmijëve të viktimës. "Ata edhe me nënë e babë ishin ku thërret qameti, po tani si do shkojë halli i tyre", - shprehen të afërmit. "Lotët e dy vajzave nuk pushonin, e kishin të vështirë të shkëputeshin nga nëna e tyre që i kish rritur me mundime, ishte kujdesur që të shkonin në shkollë, pavarësisht se prej vitesh ishte përballur me dhunën e një burri xheloz, që nuk e lejonte të shihte dritën e diellit", thonë dëshmitarët. Mësohet se 40-vjeçarja u përçoll për në banesën e fundit nga tre fëmijët e saj më të mëdhenj, djali i 18-vjeçar dhe dy vajzat 15 e 14 vjeçe. Të afërmit e viktimës, me dhimbje tregojnë se tre fëmijët e tjerë të Ardjanës, më i vogli të jetë vjeç ishin nisur në një kamp veror pushimi me një nga shoqatat që ndihmonte familjen nga Durrësi.



Ardjana Shaholli

FËMIJËT

40-vjeçarja u përçoll për në banesën e fundit nga tre fëmijët e saj më të mëdhenj, djali 18-vjeçar dhe dy vajzat 15 e 14 vjeçe. Të afërmit e viktimës, me dhimbje tregojnë se tre fëmijët e tjerë të Ardjanës, më i vogli të jetë vjeç ishin nisur në një kamp veror pushimi me një nga shoqatat që ndihmonte familjen nga Durrësi.

që ndihmonte familjen nga Durrësi, të skeuduar prej kohës si familje me probleme të theksuara ekonomike e sociale.

NGJARJA

Burime zyrtare nga policia e Durrësit bënë me dije se "rreth orës 19:55 të së premtës, në urgjencën e spitalit rajonal të Durrësit ka shkuar e lënduar në kokë dhe ka ndërruar jetë shtetasia A.Sh. 40 vjeçe, banuese në lagjen nr.15. Nga hetimet e kryera ka rezultuar se autor i dyshuar është bashkëshorti i saj, shtetasi Çlirim Shaholli, 42 vjeç, i cili e ka goditur me mjete të forta. Shtetasi i mësipërm është shoqëruar në ambientet e policisë



Ceremonia mortore

TË AFËRMIT

Sipas të afërmeve të viktimës, prej një muaji Ardjana Shaholli ishte punësuar në një lavanderi në qytetin e Durrësit, por kjo e ka përqendruar më shumë raportin me të shoqin. Të afërmit bëjnë me dije se fakti që djali i madh i 40-vjeçares ishte rritur, i kish dhënë guximin të dilte në punë.

së Durrësit", thuhet në njoftimin paraprak të policisë. Por, pas autopsisë ka rezultuar se Ana Shaholli ka vdekur për shkak të një plage në kokë, që mund të jetë shkakuar si pasojë e rrëzimit në tokë. "Viktima është futur direkt në sallën e kirurgjisë. Pavarësisht ndihmës së dhënë, ajo nuk mundi të mbijetonte. Gruaja ka goditje në kokë, që nuk është shkakuar me mjete pre-rese, por mund të jetë shkakuar si pasojë e rrëzimit në tokë", pohuan për "GSH"

burime nga spitali i Durrësit. Ndërkohë, autori i dyshuar i krimit, bashkëshorti i viktimës dha dëshiminë e tij para bluve, duke sqaruar se gjatë sherrit ai e shtyu gruan dhe ajo u rrëzua me kokë në çiment. Gjatë dëshmisë ai deklaroi se nuk donte të vriste gruan dhe se nuk beson se ajo ka vdekur. "Ajo që ndodhi është shumë e rëndë. Nuk dua ta besoj se ime shoqe nuk është më dhe se fëmijët e mi kanë mbetur pa nënë", - ka thënë 42-vjeçari.

ARRESTIMI



Arrestohet 44-vjeçari në Elbasan, dhunoi dhe i shkaktoi plagë në kokë bashkëshortes

ELBASAN- Një 44-vjeçar është arrestuar nga policia e Elbasanit gjatë ditës së djeshme, pasi ka dhunuar fizikisht dhe i ka shkakuar plagë në kokë bashkëshortes së tij. Konkretisht në pranga ka përfunduar shtetasi Saimir Nuredini, 44 vjeç, banues në lagjen "5 Maji", Elbasan. Sipas policisë, 44-vjeçari në banesën e tij për motive të dobëta ka ushtruar dhunë fizike duke i shkakuar dëmtime në kokë bashkëshortes së tij, shtetasen D.N. 43 vjeçe. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprën penale "Dhuna në Familje".

STRATI... Shërbimet për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme... "Arë" me sipërfaqe 3000 m², e ndodhur në Tiranë, Kashar, regjistruar në pronësi të Eduard Zadeja, me Nr. Pasurive 1152/36, Zona Kadastrale Nr. 2105, volumni 17, faqe 154, regjistruar në Zyrën e Pasurive të Paluajtshme Tiranë, lënë si garanci bankës përmes kontratës së hipotekës Nr. 321 Rep dhe Nr. 125 Kol datë 12.02.2007. Çmimi fillestar i ankandit është 246.960 Euro. Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 18.06.2018. Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmësimore "Strati Bailiffs Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiffs.com, info@stratibailiffs.com

Hodhën drogën në det, trafikantët humbasin gjurmët dhe u shpëtojnë autoriteteve

Kapen 2.5 tonë marijuanë në Itali, policia: Gomonia iku drejt Malit të Zi

"Nuk dihet ende origjina e lëndës narkotike"

Rreth 2.5 tonë marijuanë janë sekuestruar ditën e djeshme nga Guardia Di Finanza në afërsi të ujërave territoriale malazeze. Policia shqiptare ka dhënë detaje për operacionin antidrogë, duke saktësuar se për kapjen e ngarkesës janë angazhuar policitë e tri vendeve, përfshirë edhe atë italiane, që kanë pikasur gomonen gjatë patrullimit, si dhe ajo malazeze. Mësohet se gomonia me drogë është pikasur nga Guardia di Finanza pranë brigjeve italiane dhe policia është vënë menjëherë në ndjekje të saj. Për t'i shpëtuar kapjes nga policia, trafikantët kanë hedhur sasinë e konsiderueshme të drogës në det dhe janë larguar me shpejtësi. Pavarësisht ndjekjes nga autoritetet, bëhet me dije se trafikantët ia kanë dalë të shpëtojnë dhe të humbasin gjurmët. Ndërkohë, sipas deklaratës së policisë sh-



Foto ilustruese

qiptare, nuk dihet ende origjina dhe vendi nga ku u nis gomonia drejt Italisë. Por sipas mediave italiane, droga vinte nga jugu i Shqipërisë. "Policia italiane ka ndërmarrë një operacion antidrogë, ndërsa ka sekuestruar rreth 2.5 tonë marijuanë, e cila dyshohet se kishte ardhur nga Vlora", shkruajin mediat e huaja.

OPERACIONI

Në datën 9 qershor 2018, rreth orës 16:25, një avion i Guardia di Finanza të Pulias

gjatë kontrollit në hapësirën detare pikasë një mjet lundrues që lëvizte me shpejtësi në ujërat italiane, në largësi rreth 40 milje nga bregu. Menjëherë në ndjekje janë vënë 2 mjete lundruese të GdF duke e interceptuar mjetin lundrues të llojit gomone, i cili ishte i ngarkuar dhe lëvizte me shpejtësi. Ndërkohë, partnerët italianë kanë njoftuar Policinë Kufitare në Shqipëri. Disa mjete të Policisë Kufitare dhe të Guardia di Finanza në Dur-

rës dhe Vlorë janë vënë në gatishtëri, në pritje të hyrjes së gomones në ujërat territoriale shqiptare. Por gomonia e ngarkuar, në ndjekje nga GdF ka shtuar shpejtësinë duke hedhur në det ngarkesën. Më pas ajo i është drejtuar territorit të Malit të Zi, duke u futur në këto ujëra. Policia malazeze e ka interceptuar gomonen, por pas një ndjekjeje për rreth 1 orë, ka humbur gjurmët e saj. Ndërkohë që Guardia di Finanza ka rikupëruar mallin e hedhur në det në ujërat ndërkombëtare në afërsi të ujërave territoriale të Malit të Zi, ku rezultoi 2 tonë e 475 kilogramë marijuanë. Autoritetet policore në 3 shtete po vijojnë hetimet dhe shkëmbimin e informacionit për zbulimin dhe ndalimin e trafikantëve, por ende nuk ka të dhëna për origjinën e mallit dhe shtetin nga ku mund të jetë nisur gomonia.



Pronari i fabrikës i masakron vëllain me levë hekuri, laçiani e terrorizon me pushkë

Një sherr me leva e armë ka ndodhur tek Ish-Uzina në Laç, ku pas një konflikti shtetasi S. T., pronari i një fabrike, ka goditur me levë hekuri shtetasin D. Lama, i cili është dërguar në Spitalin e Traumës në Tiranë. Menjëherë pas këtij konflikti, vëllai të plagosurit, Rudolf Lama, ka marrë një pushkë dhe ka shkuar të fabrika e shtetasit S. T., ku e ka ofenduar dhe kërcënuar, si dhe ka qëlluar disa herë me armë. "Policia e Kurbinit ndërhyri në kohë dhe parandaloi përshkallëzimin e një konflikti, i cili agravoj deri në përdorimin e armëve të zjarrit. Policia sqaron se ngjarja ndodhi mesditën e djeshme tek Ish-Uzina në Laç, ku shtetas S.T. 48 vjeç është konfliktuar për motive të dobëta me shtetasin D. Lama, të cilin e ka goditur me mjet të fortë (levë hekuri) duke i shkakuar lëndime trupore. I plagosuri u dërgua në Spitalin e Traumës në Tiranë dhe ndodhet nën kujdesin e mjekëve. Policia e Kurbinit sqaron se, vëllai i tij, 22-vjeçari Rudolf Lama, ka marrë një armë zjarri pushkë model 63, me fishekë dhe në gjaknxehtësi ka shkuar tek fabrika e shtetasit S.T., ku e ka ofenduar; kërcënuar dhe ka qëlluar disa herë me armën e zjarrit. Falë vlerësimit në kohë të situatës dhe njoftimit për konfliktin, nga forcat policore të Komisarariatit të Policisë Kurbini është bërë e mundur ndërhyrja në kohë rekord, duke arrestuar në flagrancë shtetasin Rudolf Lama dhe sekuestruar edhe armën e zjarrit pushkë me të cilën kishte kërcënuar dhe qëlluar", thuhet në njoftimin e policisë. Rudolf Lama akuzohet për veprat penale "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit", "Kanosja" dhe "Prishje e rendit dhe qetësisë publike". Gjithashtu, u shpall në kërkim dhe punohet për kapjen e shtetasit S.T. 48 vjeç, banues në Kurbini për veprën penale "Plagosje e lehtë me dashje" parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbini, për veprime të mëtejshme.



Save the Children

TENDER NOTICE

Save the Children believes every child deserves a future. In Albania and around the world, we give children a healthy start in life, the opportunity to learn and protection from harm. We do whatever it takes for children – every day and in times of crisis – transforming their lives and the future we share.

Save the Children International in *Albania* is inviting submissions of tenders for a contract to provide the following products:

- To construct two Crèches for children 0-3 age in city of Korce and Elbasan.

Detailed technical specifications are included within the tender documents.

If you are interested in submitting a bid, please contact *Ina Sefa* at the following address procurement.albania@savethechildren.org or info.albania@savethechildren.org to express your interest and request the tender documents. Tender documents will be sent to you by return.

You may find full invitation to tender reference number 2018/001 at <https://albania.savethechildren.net/work-for-us/service-provision>.

It is recommended to request / collect the tender documents as soon as possible.

Completed tender documents are due to be submitted by 02/07/2018.

Tantuan të trafikonin drogë, kapet me 28 kg marijuanë familja shqiptare në Mal të Zi

Një familja shqiptare është ndaluar tekta kalonte kufirin e Malit të Zi drejt Kroacisë me një makinë ku kishin fshehur 53 pako me kanabis. Policia e Malit të Zi thotë se shoferi ishte një 41-vjeçar dhe se në makinë ndodhej edhe bashkëshortja së bashku me dy fëmijët e

mitur. Ata tantuan të kalonin ilegalisht në drejtim të Kroacisë 28 kg kanabis. Spas policisë së Malit të Zi, makina ishte modifikuar për të fshehur drogën. Në pjesën e pasagjerit ishte ndërtuar një pjesë e posaçme për të fshehur lëndën narkotike. Autoritetet e sigurisë të Malit të

Zi e ndaluan makinën, pasi lëndën dyshime nga një erë e fortë brenda automjetit. Kjo ka shërbyer për të ndërmarrë një kontroll të imtësishëm e më pas u gjet sasia e drogës. I arrestuari dhe bashkëshortja janë duke u marrë në pyetje nga prokurorët e Mali të Zi.



INSTITUTE OF STATISTICS OF ALBANIA
TENDER NOTIFICATION

Institute of Statistics of Albania intends to award a supply contract for "Consumables (spare parts) for server room equipment" in Tirana, Albania, with financial assistance from Sweden, represented by the Swedish International Development Cooperation Agency (Sida) under the project: Direct funding for procurement of IT-equipment and establishing a training centre, with Sida contribution nr. 55020289. The tender dossier is available at (<http://www.instat.gov.al/reth-nesh/procedura-prokurimi/>); from June 05, 2018. The deadline for submission of tenders is: June 19, 2018, time 16:00 hrs, at Institute of Statistics of Albania, Biv. "Zhan D'Ark", No. 3, Tirana, Albania. Possible additional information or clarifications/questions shall be published on the <http://www.instat.gov.al/reth-nesh/procedura-prokurimi/>. Tenderers may request clarification on any of the documents of the Tender up to the date of submission of offers.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
NJOFITIM TENDERI

Në kuadër të projektit: "Financim direkt për prokurimin e pajisjeve të IT-së dhe ngritjen e qendrës së trajnimit, "Sida contribution nr. 55020289", financuar nga qeveria Suedeze, e përfaqshuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), Instituti i Statistikave (INSTAT), Tiranë, do të zhvillojë procedurën e prokurimit me objekt: Konsumable (pjesë ndërrimi) për pajisjet e dhomës së serverave". Dokumentat e tenderit mund t'i gjeni në adresën: <http://www.instat.gov.al/reth-nesh/procedura-prokurimi/>, nga data 05.06.2018. Afati i fundit i dorëzimit të ofertave është: 19.06.2018, ora 16:00, në adresën: Instituti i Statistikave, Biv. "Zhan D'Ark", Nr. 3, Tiranë. Informacionet shtesë ose sqarime/pyetje, do të publikohen në: <http://www.instat.gov.al/reth-nesh/procedura-prokurimi/>. Kërkesa për sqarime mund të dorëzohen pranë Autoritetit Kontraktor, deri në ditën e fundit për dorëzimin e ofertave.

PROFILI | DITES

Nelson Mandela,

një lider mes luftës dhe paqes

(dhe shqiptarët në dy kohët e tij)



Nga Spartak Topollaj

(vijon nga fq. 1)


... Mandela, ky personalitet i madh afrikan i rangut botëror i dy shekujve të fundit, i shquar veçanërisht për qëndrueshmëri legjendare gati 30-vjeçare në burgjet e tmerrshme të regjimit racist të apartheidit, prej nga ku edhe drejtoi plot sukses, e mes vështirësish të panumërta, luftën për liri e të drejta të barabarta të popullsisë autoktone me ngjyrë, deri në fitore, kundër diskriminimit racial, e segregacionit. Por, a njihet ai plotësisht nga shqiptarët dhe pse në një farë kuptimi, Mandela iu mbeti borxhi atyre?!...

REPUBLIKA E AFRIKES SË JUGUT (DIKUR BASHKIMI JUGAFRIKAN)

Me mbi 55 milionë banorë dhe sipërfaqe 1 290 090 km², Republika e Afrikës së Jugut është ndër shtetet më të mëdha të kontinentit të zi. E veçantë është se ky shtet mund të jetë i vetmi vend i botës me tre kryeqytete: Pretoria, me qeverinë e administratën qendrore, Kejptaun me legjislativin, pra parlamentin dhe Bloemfontein ku ndodhet pushteti gjyqësor. E megjithatë, qyteti më i madh nuk është asnjë prej tyre, por Johannesburg, i cili mund të quhet edhe si kryeqyteti i katërt, pasi në fakt është edhe kryeqendra ekonomike. Në këtë vend, saktësisht në Transvaal, janë gjetur gjurmë të një prej qytetërimeve më të lashtë, mbi 10-mijëvjeçar të të mbiquajturit homo sapiens sapiens. Etnitë më të vjetra janë Khoikhoi, Boshmenët, Bantu, Zulu dhe Xhosa. Europianët i parë që mbërritën në këtë brigje të mrekullueshme më 1487 ishte Bartolomeo Diaz, prej të cilit morën edhe emrin, Kepi i Shpresës së Mirë. Shpejt filloi të tregojë interes dhe synime kompania holandeze e Indive Lindore, e pas saj edhe vetë Vendet e Ulëta, deri sa Napo-

lon Bonaparti që ngadhnjeu në tërë Europën, bëri të dobësohet së tepërmi pushteti dhe ndikimi i tyre. Nga kjo rrethanë përfituan britanikët, të cilët e rritën praninë e tyre në këto vise të jugut afrikan, ku boerët (katundarët holandezë) kishin krijuar disa republika të vogla, si Oranch, Natal dhe Transvaal. Personalitete të shquara të kësaj kohe ishin Paul Kruger dhe Marthinus Wessel Pretorius. Në fund të shekullit të 19 e fillim të shekullit të 20-ës zhvillohet Lufta Anglo-Boere, fituar nga të parët, e që më 1914 çoi në krijimin e Dominionit Britanik të Bashkimit Jugafrikan, pjesë e Commonwealth-it. Kuptohet që Lufta e I Botërore i rreshtoi pro Britanisë. Më 1931 Afrika e Jugut fitoi një autonomi të pjesshme, ndërsa në prag dhe gjatë Luftës së II Botërore, një pjesë e boerëve u shpallën pro nazistë, çka çoi në dorëheqjen e kryeministrit James Barry Munnik Hertzog para guvernatorit të përgjithshëm, Sir Patrick Duncan, i cili e zëvendësoi me paraardhësin e tij Jan Christiaan Smuts. Edhe pse kish vite që përponohej teorikisht dhe zbatohet

vitet 1956-1966, të cilit mund t'i njihet edhe "merita" e krijimit të Bantustaneve. Më 31 maj 1961 Afrika e Jugut shpallet republikë e pavarur, çka edhe solli përjashtimin e menjëhershëm të saj nga Commonwealthi britanik. Kryeministrit që pasuan ishin respektivisht: Balthazar Johannes Voerster 1966-1978, Marais Viljoen 1979-1984, Pieter Willem Botha 1984-1989, madje ky gjeti aleancë me Swazit-it e Mbretit Sobhuza i II. Nga 1989-1994 Frederik Willem de Klerk, me të cilin merr fund njëherë e përgjithmonë edhe apartheidi në Afrikën e Jugut! Pak shtete në botë kanë pasuri dhe klimë si Afrika e Jugut, madje ajo duhet të zërr vendin e parë në kontinent për nga prodhimi i përgjithshëm bruto (rreth 400 000 milionë \$ PIL nominale dhe PIL-PPA, rreth 600 000 milionë \$). Ajo shquhet për diamantet, arin, platinin, hekurin, kromin, bakrin, uranin dhe gymyrin etj. Sot mbi 80% e popullsisë janë njerëz me ngjyrë, ndërsa të bardhët, më pak se 10%, po aq sa edhe të përzierit. Ka 11 etni, ku tri kryesorët janë Zulu - 23%, xhosa - 18% dhe Sotho - 16%. Shumica janë



Në foto: Nelson Mandela

shqip-Grindaveci, edhe pse ai kurë s'u bë një i tillë, se më së shumti predikoi paqen dhe pajtimin). Në shkollë e regjistruan si Nelson Mandela, ndërsa brenda klanit të tij thirrej Madiba ose Dalibunga. Si akt i parë i rebelimit, atij i njihet refuzimi për t'u martuar me atë që kish përcaktuar Dalindyeo, kreu i tribusë së tij, ndaj dhe bashkë me kushërinin e vet Justice, që gjithashtu po kalonte të njëjtën situatë, shmangën fejesat me shkuesi dhe ia mbathën për në Johannesburg, ku i bashkua Kongresit Kombëtar Afrikan (KKA). Aty u njoh, u dashurua dhe u martua në vitin 1944 me bashkëshorten e tij të parë Evelyn Ntoko Mase, me të cilën bëri katër fëmijë, por u divorcua më 1958. Studimet për drejtësi i kreu shkëlqyeshëm në dy universitete, Fort Hare dhe Witwatersrand. Mandela, në fillim përqafoi ideologjinë UBAN-

TU, një ndërthurje e internacionalizmit brenda kuadrit social-demokrat të nacionalizmit afrikan. Fare i ri, rreth të 25-ave, së bashku me Walter Sisulu-n e Oliver Tambo-n e të tjerë themeluan Lidhjen e Rinisë. Fitorja e Partisë Nacionale pro Apartheid më 1948 bëri që KKA të organizohet në fushatën e rezistencës antiapartheid, gjatë së cilës Mandela shquante mbi të tjerët, sidomos për kontributin e dhënë në hartimin e Kartës së Lirisë nga Asambleja Popullore-1955. I frymëzuar nga Marksi dhe nën ndikimin edhe të Revolucionit Kuban, Mandela themeloi lëvizjen e armatosur Umkhonto We Sizwe. Në Afrikën e Jugut ishte themeluar edhe Partia Komuniste, që në të vërtetë ishte pjesë dhe krahu i majtë i KKA. Mandela ishte njëri prej liderëve kryesorë të saj. Nga ana tjetër, ai së bashku me Tambon hapën studion ligjore "M & T", e cila ofronte asis-



herë spontanisht e herë e organizuar, doktrina dhe praktika e apartheidit, diskriminimit racial dhe segregacionit, u zyrtarizua vetëm pas Luftës së II Botërore, më 1948. Ideologu kryesor dhe zbatuesi në praktikë i apartheidit ishte Hendrik Frensch Verwoerd, kryeministër në

të krishterë dhe vetëm 1,5% myslimanë.
JETA E MANDELËS
I lindur nga prindër Nosekeni Fanny dhe Gadla Henry Mphahanyiswa - familja "mbretërore" Thembu, të etnisë xhosa, si emër të parë pati Rolihlahla Mandela (në

tencë falas, apo me kosto të ulët për të varfrit e të pambrojturit. Tani për Mandelën fillon periudha e persekutimit të egër nga regjimi racist i apartheidit. Ai së bashku me 150 të tjerë më 5.12.1956 arrestohen nën akuzën e tradhtisë së lartë. Procesi gjyqësor që zgjati plot 5 vjet vërtejtoji jo vetëm forcën e karakterit të Mandelës, por edhe nivelin e lartë të përgatitjes juridike të tij dhe bashkëluftëtarëve, aq sa edhe gjykatësit e regjimit u detyruan t'u japin pafajësinë! Ndërkohë, më 21 mars 1960, pas një proteste të mijëra njerëzve të paarmatosur, ndodhi masakra e Sharpeville ku u vranë 69 protestues (10 fëmijë e 8 gra), e u plagosën 180 të tjerë (31 gra dhe 19 fëmijë). Kjo është koha kur pas ndalimit me ligj të KKA, Mandela dhe shokët e tij përsërisin thirrjet për rezistencë të armatosur. Që nga 1958, pra pas divorcit me bashkëshorten e parë, Mandela kish realizuar një martesë të dytë me Winnie Madikizela (1936-2018, e lindur Nomzamo Winifred Zanyive Madikizela Nkosikazi Nobandle, në Bizana-Pondoland), me të cilën divorcohet më 1992 (zyrtarisht më 1996). Ndërsa me të parën pati katër fëmijë, Mandela me Winnie-n kishin dy vajza, Zenani (1958) dhe Zinziwa (1960). Mendohet që shkak kryesor i divorcit me të, të kenë qenë akuzat e rënda për abuzime, korrupsion e deri nxitje për vrasje, megjithëse duhet të themë se misteri dhe enigmat e shoqëruan atë deri në vdekje. Më 11.06.1963, në Lilliesleaf Farm të Rivonias arrestohen krerët më të rëndësishëm të KKA me Mandelën në krye, e përsëri po me të njëjtën akuzë: tradhti e lartë e sabotim! Me gjithë vetëmbrojtjen e shkëlqyer të të akuzuarve dhe të treshes së famshme të avokatëve Joel Joffe, Arthur Chaskalson e George Bizos, kësaj here gjykatësit racistë të regjimit nuk mund t'u jepnin më pafajësinë (përgjastuar njërit, Rusty Bernstein), madje përkundrazi, në për-

fundim të gjyqimit, më 12.07.1964 i dënuan me burgim të përjetshëm, apo afate shumë të gjata burgimi. Në 16 korrik të vitit 1976, një tjetër masakër, kësaj radhe akoma më e madhe ndodhi në Soweto, gjatë së cilës vetëm ditën e parë u vranë 23 protestues paqësorë, ndër të cilët adoleshenti 13-vjeçar Hektor Pieteron, heroi dhe simboli i protestës. Kjo masakër e regjimit racist të kryeministrit Vorster mori përmasa shumë më të mëdha se ajo e Sharpeville, ngaqë numri i të vrarëve shkoi rreth 500, e ai i të plagosurve mbi 1000. Edhe pse i izoluar, Mandela vazhonte i paepur qëndrësën në të gjitha format e mundshme, e plot 6 vite pas burgosjes (15.07.1980), ia mbërriti të hartonte e shpërndante nga burgu një manifest të KKA. Në shkurt të 1985-ës, ai refuzoi me neveri dhe hedh poshtë lirimin me kusht nga burgu, në këmbim të heqjes dorë nga lufta. Do të ishte 11 shkurti i 1990-s, dita kur pas urdhrit të presidentit F.W. de Klerk, Mandela, tashmë pa asnjë kusht, lirohet nga burgu. Kishin kaluar jo pak, por 27 vite të një izolimi të tmerrshëm, mes dhunës e lagështirës së tre burgjeve, 'Robben Island', 'Pollsmoor Prison' dhe 'Victor Verster Prison', që i shkaktuan edhe tuberkulozin e rëndë. Por ai mbijetoj plot dinjitet, duke hapur një tjetër faqe, jo më pak të lavdishme të jetës së tij. Një rol të rëndësishëm në luftën kundër apartheidit e dallimit racia, si dhe për lirimin e Mandelës luajti edhe Desmond Mpilo Tutu (1931), Kryepeshkop i Kejptaunit, Peshkop i Johannesburgut dhe Peshkop i Lesothos, i cili më 1984, pikërisht për këto vlera, ishte nderuar me çmimin Nobel. Ende pa dalë nga burgu, më 1988, Mandelës i akordohet çmimi 'Sakharov' për Lirinë e Mendimit, më pas shumë e shumë çmime e dekorata të larta, ku më i rëndësishmi mbetet ai Nobel për Paqe më 1993. Interesant mbetet fakti se ky çmim iu akordua në të njëjtin vit edhe presidentit të kohës, F. W. de Klerk, me të cilin Mandela negocioi deri sa ia mbërriti qëllimit, organizimit të të parave zgjedhje të përgjithshme multiraciale demokratike, të fituara nga Partia e Mandelës, që u zgjodh dhe presidenti i parë me ngjyrë i Republikës së Afrikës së Jugut, (27.04.1994 - 14.06.1999 de jure) me zv.president të parë Thabo Mbeki dhe të dytë ish-presidentin de Klerk, gjest shumë domethënës ky, por jo sa krijimi i Komisionit të së Vërtetës e Ripajtimit Kombëtar, ku dhe u shfaq e plotë madhështia e personalitetit të Mandelës, si lider gati unikal në botë. Ai e kreu detyrën e presidentit (nga 10 maj 1994-16 qershor 1999 de facto), pra vetëm një mandat. Në zgjedhjet e reja president doli Mbeki, që u rizgjidh edhe për një mandat të dytë, i cili ia dorëzoi mandatin presidentit të ri, vetëm për një ditë (Ivy Matsepe-Casaburri 24-25 shtator 2008), pas të cilit, deri në maj të 2009-ës, Kgalema Motlanthe, që zëvendësohet nga Jakob Zuma, deri më 14 shkurt 2018. President aktual është zgjedhur Cyril Ramaphosa, të gjithë këta presidentë pa përjashtim, ishin përfaqësues nga KKA.

Gjatë presidencës së tij, kur edhe diskriminimi racia mori fund e u ngrit Komisioni i së Vërtetës e Ripajtimit Kombëtar, bota demokratike i njohu merita të jashtëzakonshme Nelson Mandelës, këtij lideri gati unikal, ndërsa vetë ai kishte

peng të jetës dështimin e institucioneve dhe autoriteteve shtetërore në luftën ndaj HIV/AIDS-it (u dyfishua numri i të prekurve prej saj, nga 7.6% në 14.2%), edhe pse ai këmbënguli me të madhe në mos diskriminimin e tyre. Pengu tjetër i tij ishte vendimi për pjesëmarrjen e trupave afrikano-jugore në kundërshtimin e grushtit të shtetit në Lesotho-1998, që rezultoi i gabuar dhe kontravers.

Nga ana tjetër, personaliteti e reputacioni që kishte, çoi në frymëzim dhe pranimin e këshillave të tij nga ana e përfaqësuesve të SINN FEIN-it irlandez, në tratativat e paqes me qeverinë britanike. Në ditën e 80-vjetorit të lindjes, 18.06.1998, Mandela realizoi edhe martesën e tij të tretë e të fundit, kësaj here me Graça Machel, të venë e presidentit 53-vjeçar mozambikas, të vrarë më 19 tetor 1986, Samora Moises Mashel (në një aksidë ajror, ende plot pikëpyetje, me TU-134, në Mbuzini të maleve Lebombo, në Afrikën e Jugut). Graça e lindur Simbine më 1945 ishte grauja e dytë e tij (1975-1986), pas Josina Mutembe-s.

Mandela ishte zgjedhur për një vit, 1998-1999 sekretar i përgjithshëm i të Paangazhuarve, ndërkohë që prej korrikut '91-dhjetor '97-të qëndronte në funksionin edhe të presidentit të Kongresit Kombëtar Afrikan.

Pas tërheqjes nga Presidencia, ai i vazhdoi angazhimet e tij për të drejtat shoqërore e civile të njeriut, e dha kontribut të madh që Af-



rika e Jugut të fitonte të drejtën e organizimit të "Botërorit 2010", në ceremoninë e hapjes së të cilit, një fatkeqësi e rëndë familjare e detyroi të mos merrte pjesë. Sidoqoftë, në finalen Spanjë-Holandë (1-0) dhe ceremoninë përmblylëse shumë të suksesshme të këtij Botërori ishte prezent, e nëse na lejohet të fantazojmë, një Zot e di se ç'mund të ketë ndërjerë ai në këtë humbje tjetër të pasardhësve të boerëve në tokën e lashtë të vendit të tij. Nelson Mandela njëherë dhe vlerësohej përpos të tjerave, edhe për intelligençën e madhe dhe kulturën e thellë. Ai ishte një studiues e lexues i palodhshëm, admirues pasionat i letërsisë, madje janë ruajtur shumë lirika, poezi e poema të tij në holandisht e anglisht, frymëzuar nga idhulli i tij, poeti britanik William Ernest Henley (1849-1903), sidomos me poemën e tij "Invictus".

NE VEND TË EPILOGUT - MANDELA DHE SHQIPTARËT ME Afrikën e Jugut e më pas



edhe me vetë Mandelën lidhet edhe mërgimi mbi 22-vjeçar i familjes mbretërore shqiptare në këtë vend. Pas vdekjes së Mbretit Zog në spitalin Poch, në Suresnes, afër Parisit (09.04.1961), Mbretëresha Geraldinë (06.08.1915- 23.10.2002), kjo zonjë e madhe dhe e respektuar, e njozhur edhe si Trëndafil i Bardhë i Hungarisë, që u ndje shqiptare që ditën e parë të njohjes e lidhjes me Ahmet Zogun në Tiranë, 31.12.1937, e deri sa ndërroi jetë po në Tiranë 23.10.2002, së bashku me të birin Leka (05.04.1939-30.11.2011), u larguan nga Franca për në Spanjë, ku Franko u dha imunitet diplomatik dhe strehim politik. Me vdekjen e Frankos, në Spanjë res-

përmas Gabonit për në Rhodezi, ku iu dha strehim politik nga Jan Smith. Rënia e këtij të fundit nga pushteti dhe ardhja e diktatorit marksist Mugabe (njerëzi e të cilin ishin stërvitur në Shqipëri e Enver Hoxhës dhe në Kinë) në krye të shtetit rhodezian - prill 1980, që mori emrin Zimbabëve, e detyroi Lekën të largohet për në Afrikën e Jugut, ku edhe ndihej më i sigurt. Aty blenë një fermë në Transvaal, afër Johannesburgut dhe u sistemuan mirë me idenë e një qëndrimi relativisht të gjatë, i cili zgjati plot 22 vite, deri më 22 qershor 2002, kur edhe u kthyen përfundimisht në atdhe. (Vetë Leka kishte ardhur edhe dy herë të tjera më parë në Shqipëri, më 1993 e 1997, po kjo është një tjetër histori, që ndoshta meriton një shkrim më vete.) Në mars të 1982, në Johannesburg lindi edhe princi Leka, ndërsa Geraldina dhe motra e saj Virginia erdhën në Afrikën e Jugut më 1995-ën. Raportet e Leka Zogut me pushtetin në vitet kur President i Afrikës së Jugut ishte Nelson Mandela, kaluan mes disa luhatjesh. Për arsye që i kemi shpjeguar edhe më sipër, kjo nuk duhej të ndodhte, se në fund të fundit, shqiptarët e deshën Mandelën.

Nelson Mandela ishte dhe mbeti një personalitet i madh, të cilin shqiptarët e njohin mjaft mirë dhe e vlerësojnë shumë lartë. Për dekada të tëra, çdo ditë në faqet e katërta të gazetave tona, vështirë të mungonin lajmet, opinionet, apo analizat mbi apartheidin, diskriminimin racia, masakrat, gjyqet politike, ekzekutimet, e pa diskutim edhe për qëndrestarin e paepur të popullit afrikano-jugor, ashtu siç ndodhte edhe me Radio Tiranën e fuqishme për propagandën komuniste në shqip e në gjuhë të huaja; deri në fund të botës, e më pas edhe me Radio Televizionin Shqiptar. Lirimi i Mandelës nga burgu erdhi njëkohësisht me lirinë e shqiptarëve, pa 50 viteve diktaturë gjakatare. Nuk di, nëse Mandela mësoi ndonjëherë se në burgjet e tmerrshme shqiptare të komunizmit pati shumë e shumë Mandela. Pjetër Arbnohi, Osman Kazazi, Adem Demaçi, Sami Dangelja (43 vite burg, ku edhe vdiq, rast për rekordet Guinness) Rahman Parllaku, Adem Allçi, Jusuf Vriani, Musine Kokalari e mijëra e mijëra të tjerë këtej e andej kufirit, pra gjithësi në trojet shqiptare (vetëm të ekzekutuar mbi 6000). Ndërsa në merrnim e ushqeshim çdo ditë me lajme për apartheidin dhe Mandelën, ky i fundit nuk dinte se një aparteid shumë më kriminal,

poshtëruës e depersonalizesh ishte politikë zyrtare e një regjimi stalinist, në Shqipërinë vogël e të largët të një diktatori paranojak, Enver Hoxhës, aparteide që hebreu Marks i fantazmës së komunizmit e quajti lufta e klasave. E nëse kjo mund t'i falet për periudhën e gjatë të burgimit, pas daljes në liri, aq më tepër kur edhe u bë president i takonte të tregonte, minimumi një mirënjohje publike ndaj shqiptarëve, për të cilën koha dhe historia ia dhanë rastin, në gjallje të tij, madje kur kulmonte dhe kish mbërritur apogjeun e famës e pushtetit të vet! Presidenti i parë demokrat i Shqipërisë, prof. dr. Sali Berisha ishte ndër të parët kryetarë shtetesh që përhëndeti singjerisht e përzemërsisht Mandelën kur u zgjodh president. Heshhtjen e pakuptueshme të tij në ditët e krimeve genocidiale të serbo-mëdhënjeve milosheviçianë, masakrave si ajo e Raçakut, aq e ngjashme me ato të Shqipërisë e Sowetos, deportimit me dhunë të 1 milion shqiptarëve të Kosovës nga trojet e veta etj., ne nuk e kuptuam kurrë! Dhe Kosova kishte në krye një personalitet vizionar, predikues i rrugës paqësore, dr. Rugovën, të quajtur Ghandi i Ballkanit, ashtu si kishte djemtë e FARK-ut (jo atij kolumbian), e pa diskutim dhe luftëtarët trimë të UÇK-së, të kalibrit si ai i legjendës Adem Jashari. Mandela, s'kish si të mos e dinte që NATO dhe SHBA bombarduan për 58 ditë e net rresht Serbinë, deri dhe vetë Beogradin, në pranverën e 1999-ës, pra kur Mandela akoma ishte president! Natyrisht, personaliteti të këtij formati janë gjithnjë kompleksë e të diskutueshëm, megjithatë, ata kurrë nuk duhen idealizuar. Pas 2010-ës, gjendja shëndetësore e Mandelës erdhi duke u rënduar, për shkak të vuajtjeve në kushtet e rënda të burgimit rreth 30-vjeçar, veçanërisht tuberkulozit, por edhe të tjera diagnoza, stresi, moshës e shtyrë dhe humbja e rëndë në aksident e stërmbesës 13-vjeçare Zenani, vetëm pak orë para ceremonisë së hapjes së Botërorit dhe ndeshjes Afrikë e Jugut-Meksikë (vite më parë i kishin vdekur vajza Makazive me gruan e vajzës, Evelinën dhe djali Makgatho Lewanika më 2005 nga HIV/AIDS me të dytën, Winin) e çuan Mandelën drejt shuarjes, në amshim më 5 dhjetor të 2013-ës, në Guangeng afër Johannesburgut, vetëm disa muaj pasi i kish mbushur 95 vjetët.

Shënimi

KKA (Kongresi Kombëtar Afrikan) i ka fillimet që nga 1890, po zyrtarisht njihet 8 janari 1912. *Themelues: Msane, Gumedè, Dube, Seme dhe Sol Plaatje. Më 1944 krijohet Lidhja e Re e KKA nga Anton Lembe, ndërsa më 1946, pjesë e KKA bëhet edhe Partia Komuniste e Afrikës së Jugut dhe Sindikata e Minatorëve.*

Albert John Lutuli (1898-1967), çmimi Nobel për Paqe. 1960. Kryetar i Kongresit Kombëtar Afrikan (1952-1967), i pari joeuropian dhe i pari personalitet me ngjyrë meir Nobel.

Dr: Alfred Bathini Xuma (1893-1962), president i përgjithshëm i KKA, (1940-1949).

James Sebe Moroka (1891-1985), president i KKA (1949-1952).

Oliver Reginald Kaizana Tambo (1917- 993), president i KKA (1967-1991).

(Autori është historian dhe diplomat)

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

Ornela Manjani

Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjencia. Kërkesit janë në qarkun e Korçës. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitetet e kërkesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në Agjencinë për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

FORMULARI

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkoh informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

APLIKIMI

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

DOKUMENTACIONI QË DUHET TE PARAQISNI

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjencinë'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

KORÇË

Nr./Dosjes	Brethi	Emri (Subjekti kërkuar)	Atesia 2	Mbimëri (Subjekti kërkuar)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
13	Pogradec	Banije		Agolli	Nj=739 m2 Mos/Njohje=300 m2	Me Vërtetim Kadastral Vendimi ka Planvendosjen Përkatëse
199	Pogradec	Barjam		Kovaçi	Mos/Njohje=100 m2	Kërkesa është rëzuar pasi e njëjta pronë është trajtuar më parë në favor të Skënder Zagorçani sipas G1 dt. 08.02.1994
145	Pogradec	Kostaq		Marko	5196	Me Vërtetim Kadastral Vendimi ka Planvendosjen Përkatëse
	Pogradec	Kostaq		Marko	Vendosi: Mbyllje e dosjes nr. 145	KKKP-Këshilli i Rrethit Pogradec ka mbyllur procedimin pas çështja po transferohej pranë KKKP-Bashkia Pogradec
299	Pogradec	Krisulla		Nunçi	219.	Me Vërtetim Kadastral Vendimi ka Planvendosjen
159	Pogradec	Neshet	Luman	Mersini	456	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Nuk ka Planvendosje
93	Pogradec	Nazar		Berberi	1796	Me Vërtetim Kadastral Vendimi ka Planvendosjen Përkatëse
	Pogradec	Nazar		Berberi	1436	Me Vërtetim Kadastral Vendimi nuk ka Planvendosjen Përkatëse
127	Pogradec	Eliana		Gusho	1206	Me Vërtetim Kadastral Vendimi ka Planvendosjen Përkatëse
	Pogradec	Eliana		Gusho	2512	Me Vërtetim Kadastral Vendimi ka Planvendosjen Përkatëse
	Pogradec	Eliana		Gusho		
247	Pogradec	Engjëllushë	Jashar	Shkoza	171	Me Vërtetim të Faktit Juridik Vendimi ka Planvendosjen Përkatëse
12	Pogradec	Urazi		Shuke	Mos/Njohje=145 m2	
108	Pogradec	Petrit		Prishtina	3006	Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
	Pogradec	Petrit		Prishtina		Me Vërtetim të Arkivit Vendor Shtetëror Ka Planvendosje
208	Pogradec	Lutfi		Jahja	501	Me Vërtetim Kadastral Vendimi ka Planvendosjen Përkatëse
	Pogradec	Lutfi		Jahja	88.11	Me Vërtetim Kadastral Vendimi ka Planvendosjen Përkatëse Pjesa e pa trajtuar në zotërim të vete personit
	Pogradec	Lutfi		Jahja	208	Me Vërtetim Kadastral Vendimi ka Planvendosjen Përkatëse
254	Pogradec	Jashar	Zenei	Mukollari	Nj=48 m2 Mos/Njohje=87 m2	Me Vërtetim Kadastral Vendimi nuk ka Planvendosjen Përkatëse por pretenduese
103	Pogradec	Shefqet		Zagorçani (Zgjani)	588	Me Vërtetim Arkivit Shtetëror Vendor Vendimi nuk ka Planvendosjen Përkatëse por pretenduese
	Pogradec	Shefqet		Zagorçani (Zgjani)		Me Vërtetim Arkivit Shtetëror Vendor Vendimi nuk ka Planvendosjen Përkatëse por pretenduese
4	Pogradec	Gjergji		Mato	Dyqan	Me Vërtetim Arkivit Shtetëror Vendor Vendimi nuk ka Planvendosjen Përkatëse por pretenduese
227	Pogradec	Gjergji		Shkurti	351	Me Vërtetim Kadastral Me Planvendosjen
271	Pogradec	Vasil		Cici	54	Me Vërtetim Kadastral Me Planvendosjen
	Pogradec	Vasil		Cici	595	Me Vërtetim Kadastral Me Planvendosjen

Nr./Dosjes	Brethi	Emri (Subjekti kërkuar)	Atesia 2	Mbimëri (Subjekti kërkuar)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
24	Pogradec	Nefail		Berberi	550	Me Vërtetim Arkivit Shtetëror Vendor Ka Planvendosjen
	Pogradec	Nefail		Berberi		Me Vërtetim Arkivit Shtetëror Vendor Ka Planvendosjen Nga 303 m2 janë kthyer 110 m2 me 79 dt. 25.02.1994
	Pogradec	Nefail		Berberi		Me Vërtetim Arkivit Shtetëror Vendor Ka Planvendosjen
197	Pogradec	Vilazëria		Çollaku		Me Vërtetim Arkivit Shtetëror Vendor Ka Planvendosjen
	Pogradec	Verie		Çollaku		Me Vërtetim Arkivit Shtetëror Vendor Ka Planvendosjen
	Pogradec	Verie		Çollaku		Me Vërtetim të Faktit Juridik Vendimi ka Planvendosjen
	Pogradec	Verie		Çollaku		Me Vërtetim Arkivit Shtetëror Vendor Me Vërtetim të Faktit Juridik Ka Planvendosjen
	Pogradec	Verie		Çollaku		Me Vërtetim Arkivit Shtetëror Vendor Me Vërtetim të Faktit Juridik Ka Planvendosjen
49	Pogradec	Gafer	Seit	Hoxhallari	570	Me Vërtetim Arkivit Shtetëror Vendor Ka Planvendosje
	Pogradec	Gafer	Seit	Hoxhallari	3036	Me Vërtetim Arkivit Shtetëror Vendor Ka Planvendosje
	Pogradec	Gafer	Seit	Hoxhallari	Nj=476 m2 Mos/Njohje=1024 m2	Me Vërtetim Arkivit Shtetëror Kadastral Sip. 1024 m2 Trajtuar me VKKKP familjes Beshir Aslan Qamili Berberi
206	Pogradec	Tasi	Thoma	Kostallari	1920	Me Vërtetim Arkivit Shtetëror Vendor Ka Planvendosje
	Pogradec	Tasi	Thoma	Kostallari	2607	Me Vërtetim Arkivit Shtetëror Vendor Ka Planvendosje
316	Pogradec	Kristina		Gusho	Mos/Njohje=5000 m2	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
82	Pogradec	Dhimitër		Blilazhde	Mos/Njohje=2628 m2	Kjo sip. është trajtuar me 285 dt. 25.05.1995 njohur Gligjeri Matos e cila është motra e kërkuarit Dhimitër dhe e bija e Zisi Blilazhde
2	Pogradec	Nysret	Isuf	Minarolli	50	Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje
32	Pogradec	Aleksandra		Vesho	270	Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje
342	Pogradec	Minella	Vangjel	Vako	1190	Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje
144	Pogradec	Suat	Gazerma		1160	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
6	Pogradec	Argjete	Dhosi	Pirçoni	1300	Me Vendim Gjykatë s'hrpënim Ka Planvendosje
122	Pogradec	Ilo	Miti	Mato	987	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
115	Pogradec	Thoma	Mihal	Pano	3340	Me Vërtetim Kadastral Vërtetimi i Arkivit të Shtetit Ka Planvendosje
	Pogradec	Thoma	Mihal	Pano	1200	Me Vendim Gjykatë Ka Planvendosje
170	Pogradec	Naum	Petraç	Mengri	450	Me Hipotekë Ka Planvendosje
252	Pogradec	Kopi	Sotir	Shkurti	1038	Me Vërtetim Kadastral Vërtetimi i Arkivit të Shtetit Ka Planvendosje

Pogradec	Kopi	Sotir	Shkurti	Vendosi: Mbylljen e Dosjes 352 dt. 25.05.1994	Sipërfaqja e Pretenduar është trajtuar me 445 dt. 03.04.1996 trajtuar 1038 m ² ndërsa sipërfaqja 1160 m ² + 540 m ² jashtë vijave kufizuese
29	Pogradec	Urazi	Todi	Vako	81.8
Pogradec	Urazi	Todi	Vako		1200
260	Pogradec	Bajame		(Kresta) Mançellari	442
20	Pogradec	Roksani		Gusho	103.2
Pogradec	Roksani		Gusho	Vendosi: Të mbyllë dosjen pasi sipërfaqja është trajtuar me 04.09.1993	
258	Pogradec	Filoreta		Vesho	36
Pogradec	Filoreta		Vesho		2144
34	Pogradec	Nedime	Alii	Zgjani	600
141	Pogradec	Agim	Hamdi	Çollaku	842
Pogradec	Agim	Hamdi	Çollaku		1376
319	Pogradec	Latif		Liçkollari	Vendosi: Të Mbyllë Dosjen 88 (319) pasi objekti është jashtë vijave kufizuese Kërkesë s'është Truall
40	Pogradec	Violeta	Aleks	Kasuli	450
200	Pogradec	Besim		Sulollari	68
305	Pogradec	Sotiraq		Ristolari	980
182	Pogradec	Lilo		Gusho(Neika)	377
131	Pogradec	Avni		Pilingi	111
60	Pogradec	Dëfrim		Okrava	2124
Pogradec	Dëfrim		Okrava		3500
117	Pogradec	Tanush		Minarolli	745
5	Pogradec	Pandeli		Dhori	1158
10	Pogradec	Hamdi		Bakollari	556
5	Pogradec	Ylli		Berberi	80
Pogradec	Ylli		Berberi	Nj=374 m ² Nj=1700 m ²	
Pogradec	Ylli		Berberi		
Pogradec	Ylli		Berberi		
343	Pogradec	Stefan		Vesho	450
19	Pogradec	Loni		Ziko	94.65
215	Pogradec	Naço		Shkurti	880
235	Pogradec	Mihallaq		Naço	2700
Pogradec	Mihallaq		Naço	Vendosi: Të Mbyllë Dosjen nr. 34	
62	Pogradec	Hali		Blaceri	Te mos miratoje kerkesen.
81	Pogradec	Riza		Hoxhallari	612
Pogradec	Riza		Hoxhallari	Nj=816 m ² Mos/Njohje=684 m ²	
12	Pogradec	Ujami,		Kyçyku	15000
Pogradec	Dhimitër		Kyçyku	Vendosi: Ndryshimi i Pikës (2) të 98 dt. 31.03.1997	
76	Pogradec	Seit		Ramadan	23
Pogradec	Seit		Ramadan	Kambellari	
288	Pogradec	Marjana		Ueka (Piliñci)	450
4	Pogradec	Uazo		Vangiel	500
69	Pogradec	Petrit		Cela	825
132	Pogradec	Naum		Jajçari	570
129	Pogradec	Piro		Kove	344
Pogradec	Piro		Kove		1200
334	Pogradec	Rako		Piqoni	282
236	Pogradec	Sotiraq		Spase	170
106	Pogradec	Elvira		Tavanxhi	112.75
323	Pogradec	Genc		Kolonja	386
163	Pogradec	Ismail		Blaceri	1203
Pogradec					
105	Pogradec	Muharrem		Blaceri	2674
175	Pogradec	Petra		Mile	460
5	Pogradec	Fation		Topçu	208.9
118	Pogradec	Efim		Ziko	1947
Pogradec	Efim		Ziko	Vendosi: Të Mbyllë dosjen 118 viti 1993	
105	Pogradec	Anthulla		Tavanxhi	112.75

64	Pogradec	Kalem		Mançellari		Vërtetim I Arkivit te Shtetit Ka Planvendosje
122	Pogradec	Naum		Ruvina	128	Vërtetim I Arkivit te Shtetit Ka Planvendosje
98	Pogradec	Jovan	Mihal	Vako	500	Vërtetim I Arkivit te Shtetit Ka Planvendosje
80	Pogradec	Vehbi	Beqir	Hoxhallari	522	Vërtetim I Arkivit te Shtetit Ka Planvendosje
44	Pogradec	Vasii		Tasellari		Vërtetim Hipotekor + Note
Pogradec	Vasii			Tasellari	1500	Vërtetim I Arkivit te Shtetit Ka Planvendosje
37	Pogradec	Skënder		Musallari	Mos/Njohje= 1200 m ²	Vërtetim I Faktit Juridik
77	Pogradec	Petrit		Elmasllari		Vërtetim I Arkivit te Shtetit Ka Planvendosje
346	Pogradec	Kadushkë & Skënder		Musallari	Nj=4674 m ² Mos/Njohje=2500 m ²	Vërtetim I Faktit Juridik Ka Hartë
53	Pogradec	Rexhep		Sinani		Vërtetim I Faktit Juridik Ka Hartë
152	Pogradec	Kopi		Mato		
Pogradec	Kopi			Mato	750	Vërtetim I Arkivit te Shtetit Ka Planvendosje
13	Pogradec	Trashigimtarët		Trashigimtarët	1472	Vërtetim I Faktit Juridik Vërtetim I Arkivit te Shtetit Ka Hartë
56	Pogradec	Kopi		Gusho	37	Vërtetim I Faktit Juridik Ka Hartë
Pogradec	Kopi			Gusho		Vërtetim I Faktit Juridik Ka Hartë
149	Pogradec	Fuat		Sulollari	787	Vërtetim I Arkivit te Shtetit Ka Hartë
Pogradec	Fuat			Sulollari	117	Vërtetim I Faktit Juridik Ka Hartë
125	Pogradec	Berut		Beqiri	60	Vërtetim Hipotekor Ka Hartë
335	Pogradec	Piro		Mile	Nj=Oqyan me përmasa 4 x 4.5 m ²	Vërtetim Hipotekor Ka Hartë
162	Pogradec	Petrit		Busho	2170e Drejta Parablerjes	Notë Transkripti Vërtetim I Arkivit te Shteti Ka Hartë
Pogradec	Petrit			Busho	1262	Notë Transkripti Vërtetim I Arkivit te Shteti Ka Hartë
Pogradec	Petrit			Busho	2000	Notë Transkripti Vërtetim I Arkivit te Shteti Ka Hartë
112	Pogradec	Sami		Kadilli	Nj=Ndërtesë 2 Katëshe sip. Truall 114 m ²	Vërtetim I Arkivit te Shtetit Ka Hartë
Pogradec	Sami			Kadilli	50	Vërtetim I Arkivit te Shtetit Ka Hartë
219	Pogradec	Vellazeria		Shuke	180	Vërtetim I Faktit Juridik Vërtetim I Arkivit te Shteti Ka Hartë
155	Pogradec	Faalli		Kromollari	3875	Vërtetim I Faktit Juridik Vërtetim I Arkivit te Shteti Ka Hartë
112	Pogradec	Piro		Çomo	801	Vërtetim I Arkivit te Shtetit Ka Hartë
99	Pogradec	Nazar		Mançellari	505	Vërtetim I Faktit Juridik Vërtetim I Arkivit te Shtetit Ka Hartë
606	Pogradec	Rexhep		Dikellari		Nuk Ka Vendim
614	Pogradec	Bardhyl		Marko		Nuk Ka Vendim
28	Pogradec	Baftjar		Dikellari	348	Vërtetim I Faktit Juridik Dokument Kadastral Vendimi ka Planvendosje përkatëse (Pjesa Tjetër ka Mbivendosje Me Vendimin nr. 421 dt. 25.02.1996)
621	Pogradec	Aleksandër		Petre		Nuk Ka Vendim
631	Pogradec	Kostaq		Marko		Nuk Ka Vendim
159	Pogradec	Genci		Hysembegasi		Nuk Ka Vendim
280	Pogradec	Piro		Dhiami		Nuk Ka Vendim
147	Pogradec	Fajli		Pengju		Nuk Ka Vendim
265	Pogradec	Aferdita		Gusho		Nuk Ka Vendim
49	Pogradec	Demirali		Biça	1120	Me Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje Vendimi
107	Pogradec	Sofokli		Ilazari	100	Me Dokument Shpronësimi Shtëpi Banimi dhe Truall në Përdorim viti 1987 me Planvendosje
326	Pogradec	Ramadan		Lipo	Mos/Njohje=200 m ²	Rëzuar Kërkesën pasi kjo pronë është njohur në përpara subjektit Sotiraq Uazari me 27.07. 05.05.1995
56	Pogradec	Avni		Blaceri	2488	Me Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje Preteduese
20	Pogradec	Florka		Manushi	350	Me Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje Preteduese
45	Pogradec	Sotir		Gollade	100	Me Dolument Shpronësimi Ka Vetëm Planvendosje Preteduese
333	Pogradec	Jetmir		Mujdari	4075	Me Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje
43	Pogradec	Piro		Tasellari	59.5	Me Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje
Pogradec	Piro			Tasellari	1200	Me Vërtetim Kadastral Ka Planvendosje sip. 815 m ² Krijon mbivendosje me vendimin nr. 121 dt. 22.04.1994 (Jonuz Berberisi)
183	Pogradec	Istref		Lipo	48.6	Me Vërtetim Arkivor Shpronësimi Me Planvendosje Vendimi
79	Pogradec	Sokol		Bega	255	Me Vërtetim Kadastral dhe Dokument Shpronësimi Ka Planvendosje Vendimi
162	Pogradec	Niazi		Topçu	469	Me Vërtetim Kadastral dhe Dokument Shpronësimi Ka Planvendosje Vendimi
Pogradec	Niazi			Topçu	1000	Me Vërtetim Kadastral dhe Dokument Shpronësimi Ka Planvendosje Vendimi
277	Pogradec	Vasii		Velo	Nj=361 m ² Mos/Njohje=668 m ²	Me Vërtetim Kadastral dhe Dokument Shpronësimi Ka Planvendosje Vendimi
97	Pogradec	Demir		Berberi	3000	Me Vërtetim Kadastral dhe Dokument Shpronësimi Ka Planvendosje
Pogradec	Demir			Berberi	1109	Me Vërtetim Kadastral Sip. 543 m ² në zotërim të kërkuarit
Pogradec	Demir			Berberi	572	Me Vërtetim Kadastral dhe Dokument Shpronësimi Ka Planvendosje Preteduese
67	Pogradec	Minir		Topçu	2106	Me Vërtetim Kadastral Me Planvendosje
Pogradec	Minir			Topçu	693	Me Vërtetim Kadastral Me Planvendosje
113	Pogradec	Zalo		Bakollari	281	Me Vërtetim Arkivit Vendor Shtetëror + Vërtetim Faktit Juridik Nuk Ka Planvendosje Vendimi
129	Pogradec	Mevludë		Pere	2482	Me Vërtetim Kadastral Me Planvendosje
18	Pogradec	Stavri		Stefa	190.5	Me Vërtetim Kadastral Me Planvendosje
39	Pogradec	Ahmet		Mukollari	1440	Me Vërtetim Kadastral Me Planvendosje Preteduese
Pogradec	Ahmet			Mukollari	302	Me Vërtetim Kadastral Me Planvendosje Preteduese
100	Pogradec	Petrit		Niko (Nasho)	996	Me Vërtetim Kadastral Me Planvendosje
42	Pogradec	Kozma	Gjokë	Basho	Nj=Ndërtesë 2 Katëshe 144 m ²	Me Dokument Shpronësimi Ka Planvendosje Preteduese
Pogradec	Kozma	Gjokë		Basho	190	Me Dokument Shpronësimi Ka Planvendosje Preteduese

Aktorët do të protestojnë edhe sot para godinës, Ben Derhemi: Po grabitet toka

Fatmira Nikollë

Qeveria, ligji i ri për shembjen e Teatrit

"Aleanca për Teatrin: Po grabitet toka publike, procedurë antikushtetuese"

Ndonëse prej muajit shkurt artistët kanë protestuar çdo javë në mënyra të ndryshme për mbrojtjen e godinës së Teatrit Kombëtar dhe mostjetër-simin e truallit të tij, ideja e kahershme e qeverisë tani po vihet në jetë me hapa konkretë. Pas prezantimit nga kryeministri të një projekti që rrudh për së gjeri hapësirën e teatrit, por e bën atë trekatësh përmes një projekti të ri, katër muaj më vonë ato që u komentuan si propozime po vijnë të prezantuara me hapa ligjorë, paçka se artistët përmes përfaqësish kanë takuar pothuajë gjitha kahet politike duke kërkuar mbështetje. Në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike është publikuar tashmë një projektligj që "rregullon" çështjen e Teatrit Kombëtar. Që në krye shënohet se është një projektligj për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar". Vetë Aleanca për Teatrin njoftoi protestë, ndërsa më herët aktori Arben Derhemi shkroi: "Me një akt të paprecedentë, qeveria ka filluar procedurën antikushtetuese të prishjes së Teatrit Kombëtar". Sipas tij, duke shmangur procedurat ligjore ekzistuese për menaxhimin e pronës publike si dhe ligjin ekzistues të Partneritetit Publik-Privat, qeveria shqiptare ka propozuar një projektligj të jashtëzakonshëm për t'i dhënë kompanisë (x) pa garë tokën e Teatrit Kombëtar. "Si mundet të grabitet toka publike dhe t'i jepet me koncesion një kompanie private? Pse nuk bëhet një tender ndërkombëtar? Pse nuk zbatohet ligji i prokurimit publik? Pse nuk zbatohet ligji i koncesioneve? Ne nuk jemi dako-



rd! Ju ftojme të na bashkoheni sot në orën 20.30 përpara godinës së Teatrit Kombëtar që të tregojmë vendosmërinë tonë në mbrojtjen jo vetëm të godinës historike, por në mbrojtje të trashëgimisë, historisë dhe identitetit tonë kulturor dhe kombëtar. #mbroteatrin", shkruante Derhemi.

PROJEKTILIGJI

Që në fillim thuhet se ky ligj ka për objekt përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, duke përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar. Në nenin

2 bëhet me dije se qëllimi i këtij ligji është realizimi i projektit për zhvillimin e një zone urbane në qytetin e Tiranës dhe ndërtimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar me partner privat. Ai përcakton se në dispozicion të zhvillimit të projektit vihen pasuritë e paluajtshme në pronësi shtet, sipas parashikimeve të këtij ligji,

Kodit Civil dhe legjislacionit për pronat e paluajtshme. Për këtë do të ketë një Komision të Negocimit, që krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe kryesohet nga kryetari i Bashkisë Tiranë ose përfaqësues i autorizuar prej tij dhe në përbërje të tij ka përfaqësues të institucioneve si më poshtë: Ministria e Drejtësisë, Min-

istria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Kulturës, Avokatura e Shtetit, Teatri Kombëtar. Komisioni i negociimit mund të thërrasë edhe përfaqësues nga institucione të tjera si dhe ekspertë të fushës që gjykojnë të nevojshëm. Nuk mund të marrin pjesë në Komisionin e Negocimit personat që kanë konflikt interesi me partnerin privat, sipas kuptimit të ligjit "Për konfliktin e interesit", për këtë arsye anëtarët e komisionin nënshkruajnë deklaratën për konfliktin e interesave. Neni 5 thotë se Komisioni i Negocimit të kontratës vlerëson dhe negocion me partnerin privat shoqërinë "Fusha" sh.p.k. propozimin e paraqitur prej tyre dhe harton projektkontratat finale të negociuar nga palët, shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave, brenda një afati kohor prej 30 ditësh nga data e ngritjes së komisionit. Neni 7 merret me afatet dhe kohëzgjatjen e kontratës në lidhje me fillimin dhe përfundimin e punimeve për godinën e re të Teatrit Kombëtar, pronësinë e aseteve, përcaktimin e sipërfaqeve përkatëse shtet që do të vendosen në dispozicion të partnerit privat në shkëmbim këto të përfundimit të godinës së re të Teatrit Kombëtar.

Neni 8 thotë se miratimi i kushteve të kontratës së negociuar do të kalojnë me dhënien e pëlqimit në parim nga Këshilli Bashkiak me shumicën e votave, në prani të shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit dhe do të dërgohet zyrtarisht nga Bashkia Tiranë pranë ministrave të përmendura në pikën 3 të nenit 6 të këtij ligji, me qëllim dërgimin për miratim në Këshillin e Ministrave. Kontrata do të nënshkruhet nga kryetari i Bashkisë Tiranë brenda afatit kohor prej 10 ditësh nga hyrja në fuqi e Vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e kontratës. Kontrata hyrë në fuqi me nënshkrimin nga kryetari i Bashkisë apo personi i autorizuar prej tij.

PROTESTA NE MBREMJE



Robert Ndrenika: Edi Rama po i përbuz artistët, sillet si Erdogani

Dje në mbremje protestuesit u mbledhën vonë. Nga Mirush Kabashi te Neritan Liçaj ata pritën edhe Ben Derhem-in derisa mbaroi shfaqjen "Rrno për me tregu". Ben Derhemi gjatë fjalës së tij u tregua shumë i ashpër kur pyeti deri ku do shkojmë gjatë protestës. "Teatri do mbrohet me gjak do apo s'do kryeministri. Ta mbrojmë historinë që të mos na thonë se jemi shoëllarë. Të dalë populli në rrugë". Ndërkaq, Rob-

ert Ndrenika tha se, kemi qenë te presidenti i Republikës dhe kryetari i Kuvendit që na kanë mbështetur. "Jam i bindur që ka shumë në Partinë Socialiste që janë me ne, por nuk e thonë publikisht. Kanë edhe ata hallet e veta. Këtu u bë puna si te 'Tre musketierët' - Kardinali Rishelje më vete, këta të mbretit më vete. Nuk ka lezet. I them dhe prokurorisë ta shohë këtë punë. Le ta marrë ta hetojë. Më vjen keq që nuk



e kanë përfillur fare komunitetin artistik. Kryeministria e ka përbuzur komunitetin. Të hyjnë në bisedime jo kështu në mënyrë arbitrarë. Vetëm Erdogani i bën kështu".



MJEKU POPULLOR




Ylli Merja:
Si të shkri
gurët në tëmth
me rigo

KESHILLA



Si të kuptoni që
vuani nga anemia,
mënyra për
trajtimin e saj

Megina Laçka:

Dermatologia: 
Kujdes nga
produktet
e yndyrshme
kozmetike,
rrezikshmëria e
sëmundjes



Si të trajtoni aknet në fytyrë, këshillat

"Adoleshentët, më të
predispozuar për t'u prekur"

• Konsumoni këto produkte për një gjumë të qetë. Si të trajtoni çrregullimet hormonale

Dermatologia: Kujdes nga produktet e yndyrshme kozmetike, rrezikshmëria e sëmundjes

Megina Laçka:

Si të trajtoni aknet në fytyrë, këshillat

"Adoleshentët, më të predispozuar për t'u prekur"

Voltiza Duro

Në lëkurë e bukur dhe e shëndetshme është ëndërr për çdo person e veçanërisht për femrat. Por në momentin kur niveli i hormonit androgjen rritet, atëherë shfaqen aknet, kjo nis që në periudhën e adoleshencës. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", dermatologjia, njëkohësisht biokimistja Megina Laçka tregon të gjithë faktorët që ndikojnë në zhvillimin e këtyre puçrrave. Ajo më tej jep disa këshilla të vlefshme për një trajtim sa më efikas të akneve.

Çfarë janë aknet?

Aknet njihen në mjekësi me emrin Akne Vulgaris dhe përkufizohen si një sëmundje e lëkurës, e cila përfshin gjëndrat e yndyrës në bazën e folikulave të qimeve. Zakonisht sëmundja shfaqet gjatë moshës së pubertetit, kur sapo fillojnë të zhvillohen gjëndrat e yndyrës - këto gjëndra stimulohen nga hormone mashkullore, të cilat prodhohen në gjëndrat mbiveshkore, si tek femrat ashtu edhe tek meshkujt.

A është e rrezikshme kjo sëmundje dhe si zhvillohet?

Aknet nuk janë të rrezikshme, por mund të lënë shenja në lëkurë. Lëkura e njeriut ka pore (vrima të vogla në lëkurë) të cilat lidhen me gjëndrat e yndyrës nën lëkurë. Gjëndrat lidhen me poret nëpërmjet folikulave - kanale të vogla. Këto gjëndra prodhojnë sebum, një lëng yndyror. Sebumi mbart qelizat e vdekura përmes folikulave drejt sipërfaqes së lëkurës. Gjithashtu, një qime e vogël rritet nëpërmjet foli-

kulës jashtë në sipërfaqen e lëkurës. Puçrrat zhvillohen kur folikulat bllokohen, gjë që rezulton në akumulimin e yndyrës nën lëkurë. Puçrrat zakonisht shfaqen në fytyrë, shpinë, kraharor dhe qafë. Qelizat e lëkurës, sebumi dhe qimet grumbullohen bashkë në një masë të përbashkët, e cila infektet nga bakteret dhe rezulton në inflamim. Puçrra fillon të zhvillohet kur kjo masë fillon të shpërbëhet.

Cilat janë disa nga llojet e akneve?

Ka disa lloj puçrrash akneike si: pikat e bardha që zakonisht zhvillohen dhe qëndrojnë nën lëkurë dhe janë shumë të vogla; pikat e zeza që janë qartësisht të dukshme e shfaqen në sipërfaqen e lëkurës. Pikat e zeza nuk shkaktohen nga papastërtia dhe gjërryerja e fërkimi i ashpër e lëkurës nuk i eliminon pikat e zeza. Ndërkohë edhe papulat (zonëza të inflamuar) janë të dukshme në sipërfaqen e lëkurës, këto janë ngritje të vogla të lëkurës, në ngjyrë rozë; ndërsa pustulat janë qartësisht të dukshme në sipërfaqen e lëkurës, të kuqe në bazë dhe kanë qelb në

majën e tyre. Edhe nobulet janë të dukshme në sipërfaqen e lëkurës, këto janë puçrra të forta dhe të mëdha, të dhimbshme dhe të rrënjosura thellë në lëkurë. Ndërsa cistet janë të dhimbshme dhe të mbushura me qelb. Cistet në shumicën e rasteve shkaktojnë plagë.

Çfarë i shkakton këto puçrra?

Shkaku kryesor është rritja e niveleve androgjene - androgjeni është një tip hormoni. Këto nivele rriten me hyrjen në fazën e adoleshencës. Rritja e niveleve androgjene shkakton rritjen e gjëndrave të yndyrës nën lëkurë; gjëndrat e zmadhuara prodhojnë më shumë yndyrë, yndyra e tepërt shkatërron muret qelizore në pore dhe kjo shkakton rritjen e baktereve. Gjithashtu, disa studime thonë se predispozicioni për akne në lëkurë mund të jetë gjithashtu gjenetik. Disa medika-



Dermatologia Megina Laçka

mente që përbajnë litium dhe androgjen mund të shkaktojnë gjithashtu akne. Produktet e yndyrshme kozmetike mund të shkaktojnë

shenja. Gjithmonë lajini duart para se të prekni fytyrën. Lajini gjithashtu edhe para se të aplikoni kremra, locione apo makiazh. Mos shkonte asnjëherë në gjumë me makiazh në fytyrë. Përdorni makiazh që nuk përmban vaj dhe nuk bllokton poret. Flokët grumbullojnë sebum dhe qeliza të vdekura lëkure. Pastrojini rregullisht dhe mbajini larg fytyrës. Dielli i tepërt mund të shkaktojë mbiprodhimin e yndyrës.

A ka ndonjë produkt natyral që e rekomandoni për trajtimin e kësaj sëmundjeje?

Mukusi i kërmillit është një nga substancat më të mira për trajtimin dhe rigjenerimin e lëkurës, ndoshta trajtimi më i plotë dhe më i balancuar i



akne tek njerëzit që kanë predispozicion për akne. Gjithashtu, ndryshimet hormonale gjatë shtatzënisë mund të shkaktojnë akne.

Si bëhet trajtimi i akneve?

Mënyra se si trajtohen aknet mund të varet nga ashpërsia dhe persistenca e tyre. Lani fytyrën dy herë në ditë, jo më shpesh. Përdorni sapun të butë e delikat dhe ujë të ngrohtë. Mos gjërryeri lëkurën. Pas pastrimit përdorni një locion, i cili përmban benzoyl peroksid. Mos i shtrydhni puçrrat. Duke i shtrydhur e shtyni infeksionin akoma më poshtë nën lëkurë, duke shkaktuar më shumë bllokim dhe skuqje e ënjtje të mëtejshme. Shtrydhja e puçrrave shkakton gjithashtu plagë dhe

krijuar ndonjëherë për kujdesin ndaj lëkurës. Ai përmban antioksidantë që janë në gjendje të ngadalësojnë procesin e plakjes, duke eliminuar radikalet e lira dhe përmbajtja e saj proteinike është e rëndësishme për t'i dhënë lëkurës një jetë të shëndetshme, të re dhe të tonifikuar. Mukusi i kërmillit hidraton lëkurën, e mban atë të shndritshme dhe të ushqyer, e mbron nga rrezet ultravjollcë, duke parandaluar në këtë mënyrë plakjen e parakohshme të saj. Ai ngadalëson daljen e rrudhave dhe e stimulon lëkurën që të prodhojë më shumë kolagen, si një nga substancat përgjegjëse për elasticitetin dhe bukurinë e lëkurës.



Voltiza Duro

Gurët në tëmth mund të prekin personat që vuajnë nga ceroza hepatike, ata që marrin mjekim për një kohë të gjatë, individët që kanë kolesterolin e lartë si dhe ata që dëshirojnë të realizojnë një rënie drastike në peshë brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore. Gjithashtu, gurët në tëmth janë karakteristike për femrat që janë mbipeshë, sepse ka lidhje me çrregullimet hormonale të tyre. Të gjithë kategoritë e personave të sipërpërmendur kanë lidhje me kolesterolin e vetë gurët në tëmth janë lipide e kristalizime të tyre, e këto të fundit mund të ndodhë që të bashkohen e të marrin formën e një guri. Në momentin që lëngu në tëmth nuk qarkullon lirshëm nga fshikëza e tëmthit në kanalën e saj e nuk ka një shkarkim të rregullt të tëmthit, atëherë ndodh që këto substanca të përqendrohen, të kristalizohen e të bashkohen me njëra-tjetrën. Pra në fillim, krijohet një si "mjegull" (pezulli), e më tej llumi, duke u bashkuar me molekulat e kolesterolit krijojnë gurëza të vegjël në tëmth. Nëse personi nuk i kushton kujdes pastrimit të gurëve në fazën që janë 1-2 milimetra (që është periudha më e mirë për t'i hequr) atëherë në sipërfaqen e jashtme të gurëve do të vazhdojnë të akumulohen e grumbullohen kristale të kolesterolit ose grimca të llumit biliar të tëmthit. Ky gur pas disa kohësh do të fillojë të marrë një pamje më të madhe, më të plotë, pra do të progresojë rritjen më tej. Nëse guri krijohet vetëm nga lipidet, pra nga kolesterolin ngjyra e tij do të jetë e verdhë, ndërsa kur kemi të bëjmë edhe me një përqendrim të bilës, atëherë këto gurë do të kenë një ngjyrë të kuqërremtë apo kafe në të errët. Ndërkohë në grupin e tretë të gurëve të tëmthit futen ato përbërje që krijojnë nga kolesterolit dhe veprimi i lëngut të tëmthit.

Simptomat

Në përgjithësi, personat që kanë gurë në tëmth në shumicën e rasteve nuk e kuptojnë që kanë një gur në tëmth e madje e zbulojnë rastësisht gjatë kryerjes së ekos. Guri fillon të bëhet i bezdisshëm e të japë dhimbje në rastet kur orga-



Mjeku popullor: Femrat mbipeshë e me çrregullime hormonale, më të predispozuar nga sëmundja

YLLI MERJA: Si të shkrini gurët në tëmth me rigon

"Efektet e mrekullueshme të mendrës"



Mjeku popullor, Ylli Merja

nizmi kapet nga një infektion, por gjithësesi treguesi më i mirë është edhe goja e thatë, apo ndjesi e hidhur e personit të prekur. Në momentin që ky i fundit konsumon një ushqim me yndyrë të tepërt, mund të ndjejë vajin në grykë, ose t'i shfaqet ndonjë dhimbje e lehtë në krahun e djathtë, poshtë brinjës dhe në shpatull. Këto simptoma janë

tipike të pranisë së gurëve në tëmth e rekomandohet që femrat mbi peshë, apo ato që vuajnë nga obeziteti të bëjnë kontrolle të vazhdueshme të mjekut. Ekzaminimi bëhet me ekonëpërmjet së cilës kuptohet praninë e gurëve në tëmth apo jo, si dhe kontrolli i vezikës së tëmthit. Nëse në këtë të fundit konstatohet se muret kanë fillu-

ar të trashen, atëherë krahas gurëve ka edhe infektion të tëmthit, situatë e cila shohet me dhimbje të shumta e kriza të forta. Vlen të theksohet se moshat më të prekura nga kjo sëmundje janë personat e grupmoshës 40-60 vjeç.

Trajtimi me bimë mjekësore Në momentin që pacienti kon-

staton praninë e gurëve në tëmth, atëherë patjetër duhet të fillojë trajtimi me bimë mjekësore, në mënyrë që të mos i nënshtrohet një ndërhyrje kirurgjikale. Nëse personi ka një nga simptomat e sipërpërmendura, rekomandohet konsumimi i rigonit. Pra, të hidhet sa më shumë nga kjo bimë në gjellë dhe do të vini re që përbërësit aktivë të rigonit jo vetëm do i lehtësojnë tretjen e do t'u pastrojnë mushkëritë, por edhe do fillojnë të japin efektet e para në shkrirjen e gurit. Llumi do të fillojë të dalë më shpejt, kurse gurët do të gërryhen. Gjithashtu, nëse pacientët kanë ndjesinë që ushqimi në muret e stomakut rri i thatë, atëherë duhet të konsumojnë rigonin të kombinuar me mendër, pasi janë dy bimë që japin efekte të mrekullueshme në qetësimin e dhimbjeve të tëmthit, nxisin e përmirësojnë funksionin e mëlçisë, bëjnë të mundur të prodhohet më shumë lëng biliar në tëmth si dhe ndihmojnë në shkrirjen e gurëve. Në rastet kur gurët janë më të mëdhenj se 4-5 milimetra, atëherë kombinimi i bimëve të sipërpërmendura nuk kanë më fuqi vepruese dhe duhet të shtohen përbërësit bimorë.

Anemia është një ndër çrregullimet e gjakut, që rezultojnë nga pakësimi, rënia e numrit të rruazave të kuqe të gjakut në organizmin e njeriut. Ky lloj çrregullimi mund të sjellë probleme të pariparueshme shëndetësore, si rezultat i uljes së nivelit të hemoglobinës në rruazat e kuqe, e cila është një ndër komponentët përbërës më të rëndësishëm të rruazave të kuqe të gjakut, që bën transportimin e oksigjenit në të gjitha indet e organizmit. Komplikacionet e shkaktuara janë të shumëllojshme. Shkaktarët e anemisë janë të shumtë, por ndër më të rëndësishmit mund të veçohen si: shkatërrimi i tejskajshëm i rruazave të kuqe, humbja e gjakut si pasojë e shumë faktorëve, prodhimi dhe rigjenerimi i pamjaftueshëm i rruazave të kuqe të gjakut, etj. Por, anemia rrjedh edhe nga shkaqe të tjera përveç këtyre që përmendëm më lart, siç janë: çrregullimet e trashëguara në organizmin e njeriut, kequshqyerja, si mungesa e hekurit dhe vitaminave, infeksionet e ndryshme, prezenca e disa kancerëve, ekspozimi ndaj medikamenteve toksike.

Simptomat e anemisë

Nëse dikush është i prekur nga anemia, ndër shenjat më të mundshme dhe më të zakonshme mund të jenë: zbehja e lëkurës, skuqje jo normale e buzëve dhe krijimi i një shtirati tek thonjtë. Mund të përmendim gjithashtu edhe gjendjen e lartë të irritimit, lodhjen fizike, marrje mendsh dhe takikardi (rrahje e shpejtë e zemrës). Ka edhe shenja apo simptoma të tjera, të cilat janë më tepër për t'u trajtuar në rrugë klinike dhe nuk mund të dallohen lehtësisht. Ka disa raste të prekjes së grupeve të ndryshme nga mosfunksionimi si duhet i disa proceseve fiziologjike dhe kimike. Çdo pacient ka të veçantat e veta dhe kërkon një shpjegim fiziologjik dhe klinik të ecurisë së sëmundjes që nga parandalimi, fillimi, shfaqja dhe në fund trajtimi me medikamentet e duhura.

Diagnostikimi dhe kurimi i anemisë

Në shumicën e rasteve diagnostikimi i kësaj patologjie ndodh pasi të jenë kryer një sërë testesh të përbërjes së gjakut, duke përfshirë këtu të gjithë komponentët e tij. Trajtimi varet direkt në llojin dhe shkaktarët e anemisë. Zakon-



Si të kuptoni që vuani nga anemia, mënyra për trajtimin e saj


gjakut brenda sistemit të qarkullimit.

Si ta kurojmë aneminë me bimë mjekësore

Përvoja ka treguar se edhe kurat popullore kanë dhënë rezultate të shkëlqyera në shërimin e shumë sëmundjeve. Disa prej kurave të përgatitura me bimë mjekësore përdoren edhe për shërimin e sëmundjes së anemisë ose pagjakësisë. Anemia vjen shpesh pas një gjakderdhjeje të madhe dhe të fuqishme, mirëpo çrregullime mund të vijnë edhe si pasojë e ushqimit të dobët dhe të keq. Të sëmurët anemikë duhet të konsumojnë ushqime të shumëllojshme dhe të pasura me hekur, si mish, peshk, shpretkë, vezë, perime, fruta etj. Lëngu i shalqirit dhe mjalti ndihmon për të luftuar sëmundjen. Pirja e tri lugëve të vogla në ditë nga masa e përfutur me shalqi, karafil dhe sheqer është një kurë e mirë për të luftuar aneminë. Kjo kurë ndihmon për të trajtuar aneminë në kushtet e shtëpisë.

Këshillat

Të sëmurët anemikë duhet të konsumojnë ushqime të pasura me hekur si: mish, peshk, shpretkë, vezë, perime, fruta etj. Këtyre të sëmurëve u këshillohet përdorimi i frutave të freskëta, që përmbajnë vitaminë C, e cila ndihmon në absorbimin ose marrjen e hekurit. Nëse pinë kafe, çaj, kakao apo edhe lëngje të tjera, që përmbajnë kafeinë, duhet t'i marrin dy orë para ose pas ushqimit, sepse vështirësojnë absorbimin e hekurit. Ne kemi përzgjedhur disa nga ushqimet bazë të cilat luftojnë sëmundjen e anemisë dhe ndihmojnë të gjithë pacientët kronikë të kësaj sëmundjeje ta ndjehin sa më pak atë. Gjithçka përgatitet dhe konsumohet në kushtet e shtëpisë, pa shpenzime të mëdha financiare.



Këshilla

Konsumoni këto produkte për një gjumë të qetë

Nëse dyshoni se vuani nga nivele të larta të pagjumësisë, më poshtë do të gjeni të renditura pesë ushqime të pasura me elementë, që lehtësisht mund t'i përfshini në ushqimin tuaj të përditshëm. Në ditët e sotme, kërkimet shkencore moderne tregojnë se të paktën 90 për qind e njerëzve vuajnë nga pamjaftueshmëria e ushqyesve të domosdoshëm për nxitjen e gjumit, i cili është i rëndësishëm për një sërë aspektesh të shëndetit. Pamjaftueshmëria e këtyre përbërësve kanë lidhje me pagjumësinë, kontraktimet muskulore, stresin, sindromat paramenstruale dhe shëndeti i pakët i zemrës.



Spinaqi

Spinaqi është një perime e shkëlqyer, që mund të përfshihet lehtësisht në vaktet tuaja sa herë që të jetë e mundur. Spinaqi është i pasur me minerale. Barishtet si spinaqi përmbajnë sasi domethënëse të fibrës, folatit, kaliumit dhe vitaminat A, C, E dhe K. Përfshijeni atë në lëngje frutash dhe perimesh, salca, apo sallata. Shija e tyre jo vetëm që do të pasurohet, por ushqyesit do të jenë të shumëllojshëm.

qindja e kakaos tek çokollata, aq më e mirë do të jetë ajo për shëndetin tuaj.

Farat e kungullit

Farat e kungullit janë një tjetër burim i shijshëm dhe ushqyes. Farat e kungullit mund t'i blini të paketuara, ose t'i mblidhni të freskëta nga kungulli vetë. Pastrojini dhe piqini në furrë me pak kanellë dhe kripë. Më pas mund t'i përfshini ato në të gjitha gatimet tuaja, duke nisur nga lëngjet e frutave dhe perimeve, ëmbëlsirave apo picave.

Avokado

Në ka një frut që gjendet absolutisht kudo ai është avokado. Ky frut kombinohet shumë mirë me një larmi ushqimesh, duke nisur nga patatet e ëmbla, vezët, orizi dhe fasulet. Për më tepër, avokado është një burim fantastik i yndyrnave të shëndetshme.

Orizi i Errët

Orizi kaf nuk përmban gluten, ndaj nuk duhet shmangur edhe nga ata njerëz që kanë ndeshmëri të lartë ndaj glutenit. Orizi kaf është i pasur me fibër dhe proteinë duke u përshtatur shumë mirë në gatime orizin kaf mund ta konsumoni disa ditë në javë.

Çokollata

Shumë ekspertë të fushës së ushqyerjes besojnë se ciklet hormonale tek njeriu shkaktojnë pamjaftueshmëri të disa mineraleve. Pluhuri i kakaos është një burim i shkëlqyer i këtyre mineraleve, por nëse nuk e gjeni dot, atëherë sigurohuni të konsumoni çokollatën e zezë. Sipas studimeve, samë e lartë të jetë për-



Si të trajtoni çrregullimet hormonale

Cekuilibri hormonal mund të jetë njëri nga shkaktarët që kenë shtuar në peshë, prandaj duhet të kenë kujdes mbi mënyrën se si ushqeheni për të balancuar hormonet. Disa nga simptomat më të zakonshme që tregojnë çekuilibrin hormonal tek femrat janë dhimbje koke të vazhdueshme, luhatje të peshës, fryrje të barkut, cikël menstrual të parregullt, rrahje të shpeshta zemre etj. Kombinimi perfekt i ushqimeve që balancojnë hormonet ndihmon në lehtësimin e këtyre simptomave dhe mban sistemin e riprodhimit të shëndetshëm. Këto janë pesë ushqimet më të mira për shëndetin e gruas:

KOSI - Ekspertët e cilësojnë atë si një super ushqim për shëndetin e gruas. Ky produkt i bulmetit përmban probiotikë, që ndihmojnë në rritjen e baktereve të shëndetshme në stomak, si dhe kalium për forcimin e kockave.

Vitamina D është gjithashtu shumë e rëndësishme për balancimin e hormoneve. **PESHKU** - Acidet yndyrore omega 3 luajnë një rol jetësor në shëndetin e gruas. Ato mund të mbrojnë femrën nga sëmundjet që mund ta prekin me kalimin e moshës, si sëmundjet e zemrës,

hipertensioni, sëmundjet inflamatorë dhe depresioni.

Perimet e pasura me antioksidues -

Perimet me gjethe jeshile

Janë një burim i mirë i antioksiduesve.

Spinaqi, zarzavatet jeshile, sallata ndihmojnë në mbajtjen nën kontroll të hormoneve, ndërkohë që sigurojnë edhe lëndët e tjera ushqyese për të cilat trupi ka nevojë.

ERËZAT - Kanella, xhenxhefilli, hudhra janë disa nga erëzat më të mira që ndihmojnë femrat të balancojnë hormonet dhe të qëndrojnë të reja për një kohë të gjatë.

AVOKADO - Ky frut është i pasur me yndyra të shëndetshme, që ndihmojnë në tretjen e lëndëve ushqyese. Avokadot janë gjithashtu të pasura me fibër, magnez, kalium, vitaminë E, acid folik dhe vitaminën B, të cilat janë shumë të rëndësishme për balancimin e hormoneve.



Opinion i Ditës

Probleme komplekse në BE, as pesimizëm ekstrem, as optimizëm abstrakt

Nga Vasil Kureta

(Vijon nga faqja e parë)

...e një lloj grindjeje e brendshme në BE, por edhe brenda Perëndimit, një ngecje reale e avancimit të projektit europian, një shqetësim në rritje, por edhe një mpirje apo ngurtësim i mendimit dhe veprimit. Po piquet me shpejtësi kontradikta mes nevojës për impulse të brendshme zhvillimi e përsosje të modelit europian të zhvillimit, për vizion e ide të reja, që e ushqejnë projektin europian dhe veprimeve konkrete, që mbrojnë modelin nga kërcënime të shumëllojshme, nga brenda dhe jashtë tij, që e fuqizojnë, e bëjnë më rezistent e më të mbrojtur nga goditjet që bëhen edhe më komplekse dhe më të forta. Ka shumë nevojë për mendim krijues e veprim të mirorganizuar, për kohezion e jo grindje e ndarje, por nuk ka vend as për skepticizëm ekstrem e as për optimizëm abstrakt.

Ka nevojë për të qëndruar të bashkuar, për të kontribuar maksimalisht dhe mbajtur përgjegjësi reale nga të gjithë, në përballimin e nevojës historike që po piquet. Nevoja historike dhe përgjegjësia më e madhe sot është të mbrohet me vendosmëri e të avancohet, me mendim krijues projekti europian, i mbështetur në sistemin e vlerave. Projekti europian mbrohet duke e shtrirë atë në të gjithë hapësirën gjeografike në Europë. Pra, ka nevojë edhe për thellim, por edhe për zgjerim, sepse ndryshe nuk do të ketë as thellim e as zgjerim. BE nevojitet të merret me shumë me veten, të zgjidhë problemet e jo vetëm të regjistrojë problemet.

Në fakt, sot është grumbulluar një problematikë, që lidhet jo vetëm me përballimin e krizës së refugjatëve dhe mbrojtjen e sistemit të vlerave nga devijime konkrete brenda BE, me përballimin e efekteve të krizës dhe një problematikë për politikën shtrënguese e përballimin e rreziqeve ekonomike e financiare, me paqëndrueshmërinë e eurozonës dhe politikën fiskale, për menaxhimin e borxhit, por edhe problemet që lidhen me ndërtimin e një buxheti të qëndrueshëm në eurozonë. Diskutimi i nevojshëm për politikën shtrënguese është sa shkencor, aq edhe teknik e politik. Natyrisht, problemet e grumbulluara sociale, sidomos ai i punësit të të



rinjve plotësojnë më tej problematikën brenda BE. Në fakt, ka krizë në BE, por ka edhe frikë reale për t'u marrë seriozisht me të dhe nuk ka një strategji të plotë, të dakordësuar e të menduar mirë për përballimin e saj. BE-ja ka ekonomistë shumë të aftë e vizionarë, por me sa duket, problem mbetet politika europiane, që as po i vlerëson si duhet ato, por dhe po vonohet të veprojë e që mund të thellojë më tej krizën. Disa teorizojnë për fetishezim fiskal të Europës Veriore. Europa po lëkundet realisht edhe ekonomikisht, por edhe politikisht. Deri më sot nuk ka ndonjë reagim domethënës nga poshtë, por ai do të ndodhë, nëse nuk reagohet shpejt. Rasti i Italisë, që sollim me votë në qeverisje populistë euroskeptikë është vërtet tregues se çfarë e pret BE edhe projektin europian, nëse nuk veprohet. Ka vërtet diskutime nga strukturat e BE e komisionet e saj, siç ka edhe deklarime nga drejtues të rëndësishëm të vendeve europiane, ka shqetësim në rritje

vërtet, por nuk ka një vizion të qartë veprimi e ndryshimi, një program të adresuar qartë, nuk ka dakordësi për të marrë përgjegjësi së bashku.

Ka më shumë shqetësim për shtëpinë konkrete, se sa për shtëpinë europiane. Ka vërtet shfaqje të përgjegjshmërisë për situatën dhe mbajtje të përgjegjësive në përballimin e problemeve nga Gjermania, por edhe mërmëritje se Gjermania ka pushtet mbi të gjithë. Gjermania është fuqia më e madhe ekonomike në Europë dhe një kontribuuese më e madhe në BE, që kështu është shfaqur një mbrojtëse e fuqishme dhe efektive e qëndrueshmërisë ekonomike e politike dhe mbrojtëse e vendosur e demokracisë liberale dhe sistemit të vlerave. Roli i Gjermanisë dhe Francës për të mbrojtur projektin europian e avancuar atë, për të harmonizuar kontributet dhe përballuar tronditjet, për të ruajtur ekuilibrat brenda BE në përballimin e problemeve, efekteve të krizës ekonomike e krizave

konkrete, por edhe të krizës së refugjatëve në mbrojtjen e sistemit të vlerave ka qenë dhe është më shumë se i dobishëm.

Situata brenda BE aktualisht po ngarkohet më tej edhe nga ajo që njihet si sfida e SHBA ndaj Europës, duke i imponuar tarifa doganore 25% për çelikun dhe 10% për aluminin. Pas deklarimit të këtyre tarifave doganore nga SHBA, u konstatua një zemërim dhe nxitim për reagim nga BE e deklarime për kundërpërgjigje. Nuk ka tërheqje amerikane dhe kjo mund të sjellë tronditje, pasojat konkrete ekonomike e sociale, por edhe lëkundje e krisje në marrëdhëniet brenda Perëndimit, që nëse ndodhin, do të sjellin pasojat serioze, që do të jetë kështu një telash më shumë për BE. Në këto kushte, kur po vihet re një ngritje e re e dallgeve të nacionalizmit e populizmit, pritet një problematikë konkrete brenda hapësirës së BE e jo thekshat sa i përket përballimit të krizës së refugjatëve, që shton

nevojën e një qëndrimi sa më të bashkuar në mbrojtjen e sistemit të vlerave, që është kyçi bazë i qëndrueshmërisë dhe avancimit të BE e projektit europian. Në këto momente shfaqet edhe një zhvillim diplomatik, ku ambasadori i ri amerikan në Berlin mësohet të ketë dhënë një intervistë në "Breitbart", ku u referohet kontakteve dhe vlerësimeve për konservatorët në Europë. Ai në thelb, nxitur nga dëshitimi i politikave të majta, ka deklaruar se dëshiron të mbështesë konservatorët. "Dëshiroj të mbështes konservatorët të tjerë kudo në Europë" - ka nënvizuar ambasadori amerikan Richard Grenell. Për të argumentuar këtë qëndrim, Grenell thekson se zgjedhja e z.Trump ka mundësuar për njerëzit të thonë se, nuk mund të lejojnë klasën politike të përcaktojë se cili do të fitojë apo se cili do të jetë kandidat para zhvillimit të zgjedhjeve.

Ky pohim ngjason me një leksion të zakonshëm demokracie, por në thelb

përcjell një filozofi justifikimi të shkujdesjes për të mbrojtur demokracinë dhe sistemin e vlerave nga kundërvëniesit e rrënuesit e tyre. Në fakt, sistemi i vlerave dhe demokracia edhe kur funksionojnë, duhen mbrojtur nga sulmet e goditjet nga brenda, që përfitojnë nga funksionimi i demokracisë dhe i sistemit të vlerave, ndryshe pasojat janë të rënda. Mbrojtja aktive e demokracisë dhe sistemit të vlerave përbën nevojë e detyrim për të gjithë ata që i mbështesin këto vlera dhe avancimin demokratik. Dhe në fakt, a nuk përfitoi edhe nga një shkujdesje ndaj mbrojtjes së demokracisë, nga një legalizëm demokratik Hitleri në Gjermani dhe a nuk kanë përfituar sot nacionalistët, populistët, euroskeptikët e rrënuesit e sistemit të vlerave, në hapësirën europiane nga funksionimi i demokracisë liberale e sistemi i vlerave, teksa kanë shfaqur filozofi e qëndrime kundër projektit europian e sistemit të vlerave?

Nëse nuk mëson nga historia e nuk sheh me realizëm zhvillimet konkrete, atëherë nuk mund të quhesh viktimit, por përgjegjës real për dëmin e rrezikun që i shkaktohet modelit perëndimor të zhvillimit. Dhe nisur nga deklarimi i ambasadorit amerikan, deputeti socialdemokrat gjerman, Schafer - Gumbel shpreh ashpër pakënaqësinë e vet, duke pohuar se qytetarët europianë nuk kanë nevojë që një vasal i Trump t'u thotë se për kë duhet të votojnë. Po kështu, deklarata e ambasadorit amerikan po interpretohet edhe si përkrahje e partive nacionaliste si Alternativa për Gjermaninë dhe UKIP. Madje, ish-kryetari i Partisë Social Demokrat gjermane, Martin Schulz shkon më tej duke pohuar se Grenell nuk po sillet si ambasador, por si oficer kolonialist. Ky reagim gjerman, me ngarkesa të larta zemërimi e shqetësimi dëshmon për temperatura të larta në marrëdhëniet me SHBA. Kjo shpjegohet ndoshta edhe me faktin që Grenell ka kërkuar nga Gjermania të japë më shumë për buxhetin e NATO-s dhe që firmat gjermane duhet të tërhiqen nga Irani, ndryshe do të ballafaqohen me sanksione amerikane. Ajo që shihet direkt mund të vlerësohet si një shkelje e etikës diplomatike, sepse përtej saj, në thelb dëshmon një problematikë konkrete në marrëdhëniet mes SHBA dhe Gjermanisë, por edhe me BE.

Në këtë situatë, Putini e sheh me interes të përfitojë në shtrirjen e ndikimit në hapësirën europiane, duke menduar boshllëqet e mundshme që mund të krijohen nga grindja brenda Perëndimit. Për t'u mbrojtur nga ndonjë akuzë, Putini deklaroi se Rusia dëshiron një BE të bashkuar →



← dhe të begatë. Ai e cilëson BE-së si partnerin më të rëndësishëm tregtar dhe ekonomik të Rusisë. Ai ka mohuar se Rusia ushqen mosmarrëveshje, duke ushqyer lidhje të ngushta me lëvizjet populiste europiane, përkundrazi ne duhet të zgjerojmë bashkëpunimin me BE. Ne nuk duam të ndajmë diçka ose dikë në BE. Putin është treguar vërtet i kujdesshëm dhe pragmatik. Në përgjigje të kësaj filozofie të Putinit, kancelari austriak Kurz ka theksuar se Austria është një ndërtues i urave midis Lindjes dhe Perëndimit dhe se dëshiron të mbajë kanale të hapura me Moskën. Po kështu, kryeministri iri italian, Conte, përpara Senatit deklaroi se kabineti i tij do të mbështesë hapjen në raport me Kremlinin. Natyrisht, përballë zhvillimeve të pritshme në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, por edhe brenda Perëndimit, nuk përjashtohet edhe një marrëdhënie e re mes BE dhe Rusisë.

Që modeli perëndimor i mbështetur në sistemin e vlerave dhe demokracisë funksionale dëshmon epërsi të dukshme e standarde të larta zhvillimi, kjo nuk mund të mohohet, por bash për këtë sulmohet e ndërtohen strategji kundërvënese për ta goditur atë. Ka dhe do të ketë një strategji më intensive gjeopolitike ndaj BE-së, për të përfutur në drejtime komplekse, por edhe për ta grindur së brendshmi

e për të mbështetur e inkurajuar mentalitete, grupe e forca politike, që kanë programe që i kundërvihen nga brenda sistemit të vlerave dhe demokracisë funksionale. Pikërisht nga kjo nevojitet të mbahet më mirë në vëmendje kjo rrethanë e jo t'i hapet rrugë nënvlefësimit e shkujdesjes ndaj këtyre strategjive, në emër të përfuturimit konkret nacional. BE po kalon tani vërtet një situatë të vështirë, me probleme komplekse ekonomike, financiare e të funksionimit si BE, ku po duket se po krijohet front të përbashkët aktorë nga brenda dhe jashtë BE, që do të pengojnë më tej mendimin krijuar e hapin konkret të domosdoshëm. Ndërsa, grindja brenda Perëndimit po shton shqetësimet e pyetjet e llojit, do të kapërcehen kontradiktat brenda vetes apo do të ashpërsohen ato, duke krijuar armiqësi reale, por edhe pyetje të ligjshme të llojit jemi miq apo armiq, jemi aleatë të sigurt apo kundërshtarë të vendosur, duhet të bashkohemi më shumë për të mbrojtur modelin më të avancuar të epokës sonë, apo do të përcëpemi duke ua lehtësuar punën kundërshtarëve dhe armiqve realë ndaj sistemit të vlerave dhe demokracisë.

Ky model zhvillimi duhet mbrojtur me vendosmëri si nevojë e njerëzimit, si domosdoshmëri stabiliteti dhe zhvillimi. Që ai duhet të përsoset përmes kritikës së vetvetes dhe pasurimit të

vizionit të zhvillimit e të mos dëmtohet, qoftë edhe së brendshmi, kjo përbën përgjegjësi të lartë për të gjithë, pa përjashtuar askënd. Mbrojtja e këtij modeli është nevojë historike, ndryshe pasojat do të jenë katastrofike. Presidenti francez Macron, pas lëvizjes më të fundit amerikane, me tarifën për çeliku e alumini, tregohet i drejtpërdrejtë kur e vlerëson të gabuar në shumë drejtime: "Është e gabuar se prish balancat, duke shkaktuar fragmentarizëm dhe nacionalizëm ekonomik". Duket se po kuptohet gjithnjë e më mirë se kapërcimi i problemeve të mprehta e komplekse brenda Perëndimit dhe brenda BE kalon nga mbrojtja e sistemit të vlerave e avancimi i projektit evropian nga reformat cilësore që përsosin e lëvizin përpara zhvillimet komplekse e të qëndrueshme nga bashkimi i të gjitha forcave krijuese. Çdo ecje në rënie të lirë, ngurrim, lëkundje apo mosveprim do të ishin një dështim paralajmëruar dhe gabim i rëndë historik. Hutimi dhe pesimizmi nuk zgjidhin asgjë, por edhe një optimizëm abstrakt pa përmbajtje është dëmsjellës.

Tash është pjekur shumë nevoja e kthimit të qartë të vëmendjes dhe kokës së klasës politike europiane nga vetja, nga përballimi i problematikës së akumuluar, në aleancë të ngushtë me kërkimin shkencor dhe aktorë të tjerë, që të mundëso-

het një program e strategji komplekse shpëtimi e avancimi të projektit evropian. Në një farë kuptimi, zyrtari i lartë evropian, Juncer, ka të drejtë kur thekson se Europa duhet të ndalet së dhëni mësim për të gjitha dhe se me shtetet e tjera duhet të formojmë partneritet të barabartë dmth., që të përqendrohet vendosmërisht vëmendja nga problematika brenda BE e përballimi i nevojës së mbrojtjes së modelit të zhvillimit e avancimit të tij. Në fakt, Europa nuk ka nevojë të japë mësim si lektore, sepse flet qartë me modelin më të avancuar ekonomik, politik e social, që është sot më i avancuari dhe modeli për ta ndërtuar, për disa për ta konkurruar e për disa për ta luftuar. Juncer ka të drejtë kur thekson se ecuria e botës nuk është e mirë, por nuk mund të mohojë dot se edhe brenda shtëpisë europiane punët nuk po shkojnë mirë dhe burokracia europiane ka përgjegjësinë e saj të pamohueshme.

Në një farë, kuptimi ka të drejtë se është pjekur shumë nevoja e kthimit të kokës më shumë nga brenda vetes, nga të kuptuarit çfarë duhet bërë dhe si duhet bërë. Nëse reagon shpejt dhe vepron në këtë drejtim më e përqendruar dhe e bashkuar, atëherë BE realisht i jep një kontribut konkret mbrojtjes së vlerave, të së ardhmes së njerëzimit. Duke ecur në këtë rrugë vetëpërsosjeje, BE e

ka të sigurt edhe një vend e rol të rëndësishëm në zhvillimet botërore dhe do t'i kontribuojë më shumë sigurisë e paqes në botë. Nëse sot mendohet se BE po humb rolin e fuqinë në skenën botërore, kjo shpjegohet jo se ka dhënë leksione, por sepse nuk po vepron me vizion krijuar ndaj zhvillimeve brenda vetes, por nëse e ka thënë fjalën e vet konstruktive për zhvillimet botërore, atëherë ka ushtruar përgjegjësinë reale që ka dhe kjo nuk është tjetër veçse një detyrim dhe kontribut i dobishëm, sepse është përfaqësuese e modelit më të avancuar të zhvillimit njerëzor.

Sot është nevoja jo për fjalë e deklarime të përgjithshme, por për ide e vizion ndryshim, por mbi të gjitha është koha për të vepruar; është koha për ndryshim të shumë gjërave. Një veprim konkret dhe i menduar mirë sot vlen më shumë se deklarata të përgjithshme. Është koha për të parë dhe ecur përpara më me vendosmëri dhe përkushtim. BE duhet të reagojë, të ndryshojë e bëjë hapa konkrete, për të mos lejuar të kthehet në e sëmura e Perëndimit.

Më 6 qershor 2018

HOROSKOPI

DASHI

Jeni të shpërqendruar disi, por fatmirësisht do të arrini t'i fshihni mirë dobësitë e juaja. Nuk do të keni probleme. Nëse nuk e dini diçka, mos bëni sikur e dini. Më mirë të thuash menjëherë të vërtetën, për të shmangur gjëra të pakëndshme.

DEMI

Ngjarje të rëndësime të lidhura me punën, që janë bërë më urgjente me lëvizjet e Jupiterit jo shumë miqësor, duhet të jenë në përputhje me kërkesat e jetës në çift. Nuk do të jetë e lehtë të jeni në një ekuilibër midis jetës private dhe profesionale, por ju do t'ia dini.

BINJAKET

Nëse ke zvarritur për në fund detyrat më të mërzitshme, tani duhet të bëni përmirësime. Kjo është e vetmja rrugë për t'i rimarrë gjërat në dorë. Lërinë mënjane projektet fantastike, që nuk kanë lidhje me realitetin dhe kthehuni me këmbë në tokë.

GAFORJA

Një shtetje jashtë shtëpisë është ajo që ju duhet për t'u shkuar nga rutina e përditshme, ndoshta edhe për të vizituar vende të reja dhe interesante. Keni nevojë të ushqeni fantazinë tuaj dhe leximi i një libri të mirë mund të jetë ajo për të cilën keni nevojë.

LUANI

Për të hequr ndonjë mendim jo shumë pozitiv, mendoni për çdo gjë të bukur në jetën e juaj. Menjëherë do të kuptoni se jeni shumë me fat! Të ndryshosh nuk është e gabuar, por para se të vepron, duhet të keni në mendje një projekt shumë të qartë.

VIRGJERESHA

Favorizimi i planetëve nuk mund të mos ndodhte në një moment më të mirë për ju. Do të tejkaloni çdo lloj pengëse. Nëse një çështje po ndërlikon ekzistencën prej disa kohësh, tani më në fund gjithçka zhbolloket. Përfitoni nga mundësia për të menduar për të ardhmen.

PESHORJA

Paqëndrueshmërisë suaj i bashkohet edhe nervozizmi, duke krijuar një miksi jo të këndshme. Më mirë të jeni zgjidhje dhe të mos kërkoni më shumë probleme. Nëse sot nuk do të punoni, do keni kohë për të bërë pazar e për të blerë gjëra që ju pelqejnë.

AKREPI

Puna e mërzitshme mund të presë, sot për duhet të ketë vetëm argetim dhe hobi të shëndetshme e të këndshme. Kështu mund të kaloni kohën duke pikturuar, apo edhe pas sobes, duke përgatitur ushqime të shijshme.

SHIGJETARI

Keni përjashtuar një person pa u menduar shumë, por tani duhet të ndërtoni situatën, duke qenë se keni kuptuar si është puna. Ju takon të bëni një hap mbapa, t'u riktheheni gjërave është një lëvizje e zgjuar, kur e keni kuptuar se keni gabuar. Më mirë vonë se kurrë!

BRICJAPI

Projektet më të rëndësime fillojnë mbarë, me Jupiterin pozitiv në shenjë e juaj si edhe mundësisë që keni për t'i stimuluar talentet. Nuk e keni problem t'u tregoni të tjerëve se keni të drejtë, ja pse do t'ju ndjekin pa u sforcur.

UJORI

Të humbësh një mundësi të mirë nuk është e këndshme, por tani mos e dramatizoni. Kërkoni të tjerë, ndoshta edhe më të mirë, kështu do të keni diçka për t'u ngushëlluar. Mos u dekurajoni përballë dyshimeve të ndokujt, nevojitet kohë për t'ia dalë mbanë.

PESHQIT

Bashkëveprimi i planetëve mund të krijojë mundësinë e duhur për të menduar rreth asaj gjëje që doni me të vërtetë, duke braktisur drejtimet që nuk sjellin gjë. Një përpjekje fizike e tepërt mund t'ju krijojë shqetësim. Prandaj merrni me sport, por me masë.



AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA. ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Planifikonin sulme terroriste mbi KFOR-in, në pranga të dyshuarit

Prishtinë, arrestohen dy persona për terrorizëm

Gjykata: Donin të vendosnin eksploziv në automjet

Ditën e djeshme janë arrestuar dy persona si të dyshuar se po planifikonin sulme terroriste mbi KFOR-in. Personat janë udhëzuar për sulme vetëvrasëse, sipas gjykatës. Lajmi u bë i ditur nga Gjykata Themelore në Prishtinë, e cila miratoi kërkesën e Prokurorisë Speciale për t'u caktuar masën e paraburgimit dy të dyshuarve për veprën penale "përgatitje të veprave terroriste", ndaj KFOR-it dhe në vendet më të populluara me qytetarë.

Udhëzimit për sulm vetëvrasës

"Ekziston dyshimi i bazuar se më datën 02.06.2018, i pandehuri G.SH., me dashje i ka bërë thirrje të pandehurës E.H., në drejtim të përgatitjes së akteve terroriste në Kosovë, duke udhëzuar që të bëjnë sulm vetëvrasës me materiale eksplozive në automjet ndaj pjesëtarëve të KFOR-it në Kosovë dhe vende tjera të frekuentuara me qytetarë e duke planifikuar edhe furnizimin me armë zjarri dhe materie eksplozive, me qëllim të kryerjes së aktit terrorist", thuhet në vendimin e Gjykatës Themelore. "I pandehuri G.SH. dyshohet se gjatë muajit maj deri më datë 02.06.2018, me dashje ka planifikuar përgatitjen e akteve terroriste në Bel-



Gjykata Themelore në Prishtinë

gjikë edhe në Francë, meqë është edhe shtetas belg, duke planifikuar sulm vetëvrasës në vende të frekuentuara me qytetarë". Zbatimi i masave të fshehta të hetimit dhe monitorimi i bisedave në vende publike dhe private nga ana e Policisë së Kosovës bëri të mundur arrestimin", njoftojnë autoritetet kosovare. Sipas autoriteteve "e pandehura E.H. gjatë muajit maj deri

më datë 02.06.2018 e tutje, në bashkëveprim me të pandehurin G.SH., është përfshirë në veprimet inkriminuese të përgatitjes së akteve terroriste në Kosovë, duke planifikuar sulm vetëvrasës me materiale eksplozive në automjet ndaj forcave të KFOR-it në Kosovë, si dhe vendeve tjera të frekuentuara me qytetarë e duke u furnizuar me armë zjarri dhe materie plasëse, me

qëllim të kryerjes së aktit terrorist", thuhet në vendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Priten arrestime të tjera

Dy të arrestuarit thuhet se bashkëjetonin, ndërsa mbetet e paqartë nëse të dyshuarit i përkasin ndonjë grupi ekstremist, apo kanë planifikuar të vëmën sulme terroriste. Prokuroria Speciale nuk ka bërë të ditur në aktakuzë nëse të dyshuarit

planifikonin sulme terroriste mbi pjesëtarët e KFOR-it të ndonjë shteti të caktuar. Policia thotë se po zhvillohen hetime intensive për këtë rast dhe nuk përjashtohet mundësia që të ketë edhe arrestime tjera. Që nga viti 2012 në Kosovë janë shtuar masat e sigurisë dhe ka pasur shumë arrestime dhe dënime, për shkak se shumë të rinj kosovarë u janë bashkuar grupeve ekstremiste në luftëra në Lindjen e Mesme. Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që nga ajo kohë, rreth 300 të rinj kosovarë kanë shkuar për të luftuar në Siri dhe Irak. Afro 50 nga ata thuhet se janë vrrarë. Kosova që nga viti 2015 i është bashkuar aleancës globale kundër terrorizmit, duke miratuar edhe një ligj në Parlamentin e Kosovës që u ndalon qytetarëve të Kosovës të marrin pjesë në luftëra jashtë vendit.

Gjykata Themelore:

"I pandehuri G.SH. dyshohet se gjatë muajit maj deri më datë 02.06.2018, me dashje direkte ka planifikuar përgatitjen e akteve terroriste në Belgjikë edhe në Francë, meqë është edhe shtetas belg, duke planifikuar sulm vetëvrasës në vende të frekuentuara me qytetarë".

SHKURT

Bebja varrosset e gjallë, mbijeton për shtatë orë

Një bebe është varrosur e gjallë nga nëna adoleshente, por ka arritur të mbijetojë për shtatë orë nën tokë përpara se të shpëtohet. Duket si një mrekulli, historia e një të sapolindure braziliane, dokumentuar me video nga policia e Matto Grosso. Pamjet filmojnë operacionin e pabesueshëm të shpëtimit të së voglës nga ana e agentëve të policisë, të cilët kanë ndërhyrë pas njoftimit anonim, në shtëpinë e një 15-vjeçareje në 5 qershor. E porsalindura është shtruar në spital dhe është në kushte të qëndrueshme. Nëna kishite besuar se fëmija që ajo kishte lindur ishte e vdekur dhe për këtë arsye e ka varrosur në oborrin e shtëpisë. Ajo është lënë e lirë pas marrjes në pyetje prej disa orësh. Gjyshja e bebes dhe stërgjyshja janë arrestuar nga policia, pasi besohet se kanë qenë ato që kanë kryer aktin e tmerrshëm.

I mbytet vajza 3-vjeçare, nëna i vë flakën për ta sjellë në jetë

Një nënë i vuri flakën vajzës së saj 3-vjeçare në përpjekje për ta sjellë atë në jetë, pasi e mitura u mbyt në vaskë. Ngjarja tragjike ndodhi në Trealaë, në jug të Uellsit. 37-vjeçarja Carly Harris, e cila dyshohet se vuan nga probleme mendore, u arrestua pasi e vogla Amelia-Brooke Harris u gjet e pajetë. Por Nicole Sallam, e cila thotë se është një mike e familjes, duke folur për të përditshmen "Metro" tha se Amelia gjeti vdekjen tragjiksht pasi u mbyt në tualet, përpara se Harris, e cila siç theksoi ajo ka probleme mendore, u përpoq ta sillte në jetë duke i vënë flakën. "Mund të duket e tmerrshme e ndoshta edhe e pabesueshme për ne që nuk vuajmë nga sëmundje mendore, por në kokën e Carly me gjasë veprimi i saj kishte kuptim", tha ajo. "Është gjithçka kaq e trishtueshme. Ka shumë thashetheme për atë që ndodhi në të vërtetë dhe shumë po e quajnë Carlyn vrasëse. Ajo ka pasur mjaft probleme përgjatë viteve, por jam e sigurt se nuk do të bënte asgjë për të dëmtuar fëmijën e saj", tha një tjetër fqinje. Teksa gruaja është shoqëruar në polici deri në zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje të rëndë, autoritetet atje kanë bërë thirrje për vetëpërmbytje, për shkak të kërcënimeve të shumta që nëna 37-vjeçare ka marrë në rrjetet sociale.

Presidenti i SHBA: S'do të mbështes deklaratin finale

Trump kundër samitit të G7? Ja prapaskenat nga postimi i fundit në rrjetet sociale

Donald Trump i ka surprizuar të gjithë me deklaratën e tij të fundit. Presidenti i SHBA-ve deklaroi se nuk do të mbështesë deklaratën finale të Samitit të G7-ës, për shkak të fjalimit të kryeministrit kanadez, Justin Trudeau. Presidenti amerikan shkroi në një postim të fundit në "Twitter" se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do ta miratojnë komunikatën përfundimtare të G7 pas deklaratave "të rreme" të Trudeauu. "Ne po mendojmë për tarifën e makinave të importuara në SHBA", shtoi Trump duke sulmuar kryeministrin kanadez, Justin Trudeau, të cilin e profilizoi si "një njeri

DONALD TRUMP

"Ne po mendojmë për tarifën e makinave të importuara në SHBA. Duke pasur parasysh se Kanadaja po nxit shtimin e tarifave për fermerët, punëtorët dhe kompanitë amerikane, unë kam udhëzuar të mos mbështes komunikatën përfundimtare. Në përgjigje të kryeministrit kanadez, tarifa do të jenë 270% për produktet e qumështit", shkroi Trump në "Twitter".

të dobët dhe shumë të pandershëm", që kritikoi tarifën e vendosura nga SHBA-të. "Duke pasur parasysh se Kanadaja po nxit shtimin e tarifave për fermerët, punëtorët dhe kompanitë amerikane, unë kam udhëzuar të mos mbështes komunikatën përfundimtare", shkroi Trump,

duke deklaruar gjithashtu se tarifën e SHBA "në përgjigje të kryeministrit kanadez do të jenë 270% për produktet e qumështit". Deklarata e kryeministrit kanadez që "tërboi" trump "Ne kanadëzët jemi të mirë, jemi të arsyeshëm, por nuk pranojmë të keqtrajtohemi,



Donald Trump

kjo është fjalja e artikullit nga Trudeauu, që "tërboi" Trumpin. Kryeministri kanadez, Justin Trudeau, gjatë një konference për shtyp në Charlevoix kritikoi ashpër taksat mbi çelikut dhe aluminin të vendosura nga Shtëpia e Bardhë për Kanadanë, Meksikën dhe Evropën. "Unë i thashë pres-

identit amerikan drejtpërdrejt se kanadëzët nuk do të lejojnë që Shtetet e Bashkuara të vendosin tarifa që dëmtojnë industrinë tonë të çelikut dhe aluminin. Për ne që kemi luftuar krah për krah me amerikanët në Luftën e Parë Botërore, kjo është një fytyrë", - tha ai.

BATUTA



De Gea: Do më përzënë nga Mançesteri, sepse dëgjoj "Metallica"

David De Gea është një nga futbollistët më të vlerësuar në botë për aftësitë e tij në mbrojtje të katërkëndorit të Mançester Junajtidi dhe Spanjës. Por e njëjta gjë me sa duket nuk mund të thuhet për shijet e tij muzikore, të cilat janë

bërë objekt problemesh në dhomat e zhveshjeve. Ingacmuar nëse mund të kthehet në Spanjë, ku kërkohet nga Real Madrid, De Gea është përgjigjur me humor, duke shpjeguar se shokët e skuadrës të Mançester Junajtidi nuk do ta kishin

problem. "Unë vendos gjithmonë muzikën që më pëlqen dhe është e vërtetë që ndonjë ditë mund të më përkashojnë nga dhomat e zhveshjeve. Mua më kritikojnë gjithmonë për muzikën që vendos, por mundohem që të zgjedh muzikë të mirë. Aty-

re u pëlqen të dëgjojnë muzikë të ndryshme, por unë gjithmonë vendos nga ajo që më pëlqen mua. Unë tërhiqem nga grupet e muzikës 'rock' apo 'metal' si 'Avenged Sevenfold' dhe 'Metallica'. Kur vendos këtë muzikë në dhomat e zhveshjeve, të gjithë ankojnë. Pjesa më e madhe e lojtarëve pëlqejnë muzikën 'hip-hop', shpjegoi De Gea.

"Los Blancos" të lodhur me tekta e CR7, shohin nga mesfushori serb i Lacios

Blancos" janë të gatshëm të ofrojnë 150 milionë euro plus 20 milionë euro bonuse në varësi të performancës së Milinkoviç-Saviç dhe arrijtjeve të klubit. 23-vjeçari gjithashtu do të fitonte shumë edhe në aspektin personal, pasi i garantohet një pagë me vlerë 6 milionë euro në vit, e cila do të rritet me kalimin e kohës për pesë sezone. Milinkoviç-Saviç në një intervistë për "FIFA.com" e pranoi se ai është një mbështetës i përtjetshëm i Real Madridit. Në ditët e fundit u raportua nga media pranë klubit të Juventusit se mesfushori 23-vjeçar u ka thënë shokëve të Lacios se do të bashkohet me "Zonjën e Vjetër". Milinkoviç-Saviç dukej i sigurt për kalimin te Juve, por kur shikon interesin e klubit më të madh në botë, gjithçka mund të ndryshojë. Për më tepër, Lacio kërkoi të përfitojë sa më shumë dhe asnjë klub në botë nuk mund të ofrojë më tepër se Real Madridi, edhe pse vitet e fundit klube si Siti dhe Paris SG, që drejtohen nga sheikë kanë treguar se mund të investojnë edhe shuma të paimagjinueshme. Rasti i fundit është transferimi i Nejmarit te PSG për 222 milionë euro. Në fakt, edhe për brazilianin Reali ka shfaqur interes dhe është gati të investojë deri në 400 milionë euro për ta kthyer në La Liga.

Jeton Selimi



Revolucioni i Real Madridit, ikën Ronaldo, vjen Milinkoviç-Saviç

Perez nuk pranon kushtet e sulmuesit portugez

Kanë kaluar 15 ditë që kur Real Madridi fitoi Ligën e Kampionëve për herë të tretë radhazi dhe përfundoi ciklin më të mirë të çdo klubi bashkëkohor. Dy javë në të cilat Zinedin Zidane deklaroi lamtumirën, por plaga e hapur nga Kristiano Ronaldo në Kiev nuk është shëruar akoma. Klubi i bëri atij një ofertë në gjysmë të rrugës. Njëzet e pesë milionë euro në vit me një seri shpërblimesh dhe shifra arrin deri në 33 milionë euro. Për një futbollist, do të mendoni se një ofertë e tillë do të ishte pozitive, por është e njohur, sidomos nga shokët e tij, se ai nuk veprim mirë pas ndeshjes kundër Liverpoolit. Ata nuk e meritojnë zbehjen, ai nuk duhet ta kishte bërë atë deklaratë në atë moment. Është distancuar nga presidenti, por dëmi nuk është i pakthyeshëm. Në "Santiago Bernabeu", ata janë të lënduar nga veprimet e yllit portugez, por besojnë se ka një zgjidhje. Lufta e ftohtë mes Florentino Perez të Realit dhe Kristiano Ronal-



dos të Madeira është rruga "Sesame", kur krahasohet me marrëdhëniet mes "Santiago Bernabeu" dhe Alfredo Di Stefano. Qershori shënon 54-vjetorin e largimit të ish-

sulmuesit dhe ndarja e tij nga Bernabeu nuk ishte miqësore. Ishte qershor 1964 dhe presidenti nuk do ta mirëpriste lojtarin yll në zyrën e tij. Një drejtues mod-

est e bëri vendimin e qartë të "Los Blancos" për të mos rinovuar kontratën e argentinasi, gjë që e rëndoi Di Stefanon. "Unë kam ngritur zërin para se të largohesha,

mbi të gjitha jam një lojtar", shpjegoi ai për "ABC". Është e vërtetë që gjetja e një zëvendësimi për të dy, Ronaldo dhe Zidane është më e vështirë se të qëndrojnë i gjallë në "PlayStation 4", por duhet të mbahet mend se Di Stefano u largua dhe Real Madridi dhe fitoi Kupën Evropiane dy vjet më vonë.

Saviç

Real Madridi thuhet se është gati të ofrojë 170 milionë euro për yllin e Lacios, Sergej Milinkoviç-Saviç, duke sfiduar Juventusin dhe Mançester Junajtidin. Serbi nuk ka një klauzolë lirimi në kontratën e tij dhe presidenti Klaudio Lotito ka thënë tashmë se ai hodhi poshtë një ofertë të madhe, duke dashur shumë më tepër se 100 milionë euro për mesfushorin 23-vjeçar. Sipas gazetës "Il Messaggero" dhe gazetës spanjolle "AS", "Los

MBROJTËSI KUQEZI

E ardhmja e Arlind Ajetit është larg Torinos e sipas të gjitha gjasave, edhe larg Serisë A. Të paktën kështu shpresojnë të klubi i tij, që e shohin se mundësia e vetme për të shitur kartonin e lojtarit në vitin e fundit të kontratës është të një klub i Bundesligës. Pas provës jo edhe aq pozitive të Krotone, Ajeti kthehet përsëri te Torino këtë verë, për të mbyllur vitin e fundit të kontratës që nënshkroi me skuadrën italiane në verën e vitit 2016. Mbrojtësi i përfaqësueses kuqezi është

Ajeti larg Torinos, shfaqet Fraiburgu

lajmëruar se nuk ka hapësira në radhët e këtij klubi dhe se duhet të gjejë një sistemim të ri për të ardhmen. Por për momentin, nuk ka asnjë ofertë në horizont për futbollistin, i cili rrezikon që të mbetet të stërvitet i vetëm në ambientet e klubit të tij, pasi nuk do të jetë pjesë e grupit të lojtarëve që do të mblidhen për fazën përgatitore të Torinos në fillim të korrikut. Te Torino duan të përfitojnë diçka nga transferimi i futbollistit që morën me parametër

zero në verë dhe sipas mediave italiane, shpresojnë që në garë për të kthehet Fraiburgu, ashtu si verën e kaluar. Atëherë Ajeti e kishte si opsion transferimin në Gjermani, por nuk e pranoi, për të zgjedhur Krotonen. Tani, duke parë se në Itali e ka të vështirë të luajë rregullisht, mbrojtësi mund të zgjedhë t'u thotë "po" gjermanëve në klubin ku luan edhe Abrashi, gjithmonë nëse këta të fundit janë ende të interesuar për të.

RISIA

FIFA vendos: "Botërori 2026" do të ketë 48 ekipe

FIFA ka vendosur që në vitin 2026, Kupa e Botës të zhvillohet me pjesëmarrjen e 48 skuadrave, duke ndryshuar numrin e ekipeve që do të garojnë në fazën finale, ashtu si edhe strukturën e saj. Megjithatë, vendet e Amerikës së Jugut kërkohet që numri 48 i skuadrave të aplikohet që pas katër vitesh, në "Katar 2022". Por presidenti i FIFA-s, Xhani In-

fantino, ka saktësuar se kërkesa e CONMEBOL, konfederatës së vendeve të Amerikës së Jugut, nuk do të votohet në kongresin e kësaj jave në Moskë dhe pas katër vitesh do të aplikohet përsëri skema me 32 ekipe pjesëmarrëse. Infantino ishte në fakt promotori kryesor që turneu në Katar të zhvillohej me 48 skuadra, duke i shtyrë vendet e Amerikës së Jugut që të bënin këtë kërkesë. Por Katari ka bërë

të qartë se e ka të pamundur nga pikëpamja logjistike që të akomodojë dhe të sigurojë mbarëvajtjen e një turneu me 48 skuadra për një periudhë kaq të shkurtër, pasi edhe vendet fqinje nuk duan ta ndihmojnë për shkak të situatës politike në rajon. Kjo e ka detyruar Infantinon të heqë dorë nga plani i tij, nëpërmjet të cilit mendonte se do të siguronte më shumë vota në zgjedhjet e ardhshme.

PRESIDENTI I FSHF-së



Duka: Me veprat e tij, Vokrrit ka siguruar përjetësinë

Gjatë ditës së djeshme janë zhvilluar në Prishtinë homazhet për Fadil Vokrrin, pas ndarjes së tij nga jeta në mënyrë të papritur. Kreu i FSHF-së, Armando Duka, i gjendur në këto homazhe është shprehur se Vokrrit e ka sig-
 uruar përjetshmërinë nëpërmjet veprave që ka bërë gjatë jetës. "Në fakt, nuk e mendoja se do të isha në këtë ditë për të folur për këtë gjë. Nuk e mendoja se do të vija në Prishtinë për të përcjellë Fadilin. Për mua ai është futbollisti më

i madh në Shqipëri. Unë kam humbur një mik dhe nuk po e them vetëm si një fjalë rasti. E kam menduar si të pabesueshme dhe lajm të rremë, por ja që isha gabuar. Ai nuk e njihte diplomacinë dhe ta thoshte të vërtetën në sy. Për këtë mendoj se kemi humbur shumë. Ka humbur i gjithë sporti një njeri të mrekullueshëm. Ai ka siguruar përjetshmërinë e

tij me veprat që ka bërë gjatë jetës. Tashmë ne nuk kemi asgjë në dorë ta ndryshojmë. Ai nuk më ka thënë kurrë një fjalë të keqe, pavarësisht punës sonë. Herën e fundit që e kam takuar ishte para 10 ditësh, ku kemi pirë verë të kuqe së bashku. Piu me tepër se mua dhe sa mirë që bëri kështu", ka thënë Armando Duka për "Supersport".

Nga Meta te Haradinaj, nga Boban te Ceferin, të gjithë kujtuan ish-numrin 9 të Prishtinës



Jeton Selimi

Homazhe një legjende! Shqiptarët i përulen Vokrrit

Qindra komente, serbët mallëngjehen për sulmuesin

9 qershori ishte një ditë e trishtë për futbollin shqiptar. Dje, më 9 qershor, u shua krejt papritur Fadil Vokrrit! Njeriu që mori përsipër betejën e madhe të anëtarësimit e Kosovës në familjen e madhe të futbollit. Njeriu që në vizionin e tij kishte ëndrra edhe më të mëdha, por që fatkeqësisht ataku kardiak ia preu në mes. Fadil Vokrrit nuk ka nevojë për reklamë! Shqiptari më i respektuar mes serbëve, njeriu që i dha aq shumë Prishtinës dhe më pas Partizanit të Beogradit, aq sa u bë edhe kapiten i skuadrës së dytë më të titulluar në ish-Jugosllavi. 18 golat në 55 ndeshje bënë që Ivica Osim ta thërriste "nën armë" në përfaqësuesen e ish-Jugosllavisë. Për të 12 ndeshje dhe 6 gola dhe më pas aventura në Turqi të Fenerbahçja, dy sezone 19 gola, bënë që Vokrrit të zërrë një vend të veçantë edhe përjetë Bosforit. Pastaj kush nuk e mban mend sfidën e bardhezinjve të Beogradit me Flamurtarin e Kushtës? Një nga sfidat e pakta të klubeve shqiptare që është shndërruar në epope, me Davidin shqiptar që mposh-



ti Golian jugosllav. Por, se cili ishte Vokrrit për Partizanin e Beogradit, mjafton të lexoni qindra komentet e tifozëve bardhezinj në faqen e klubit. Dje në homazhet e të ndjer-

it ishin të gjithë. Në hollin e Teatrit të Kosovës, me flamurin që gjysmështrijë, nuk mungoi personi që e shoqëroi më së shumti në këtë rrugëtim, Armand Duka,

presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit. Nuk mungoi as presidenti Ilir Meta, që kreu nderimet ndaj të ndjerit. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryem-

inistri i Kosovës Ramush Hajradinaj e shumë personalitete të tjera të politikës. Gjeniu i topit, Zvonimir Boban ishte aty në emër të FIFA-s, ndërsa presidenti i UEFA-s, Aleksandër Ceferin, nëpërmjet faqes zyrtare të UEFA-s u shpreh i tronditur nga kjo humbje e parakohshme e një njeriu që luftoi derisa përmbushi ëndrrën e tij, të anëtarësonte Kosovën në FIFA dhe UEFA. Mijëra njerëz përcollën të ndjerin për në banesën e fundit, ku nuk munguan edhe grupe të organizuara tifozësh si ata të Prishtinës apo "Dardanët", që mbështesin çdo sfidë të përfaqësueses bluverdhë. Fadil Vokrrit ishte një numër 9 tipik, një sulmues zone. Kishte një gjuajtje të fortë dhe një dribllim të shkëlqyer. Më 9 qershor bëri lëvizjen e tij të fundit, duke na "dribluar" dhe shtangur të gjithëve!

Lamtumirë Fadil, lamtumirë legjendë!

NDERIMI



Një flamur kuqezi zbret nga qielli për Vokrrin

Është përcjellë për në banesën e fundit legjenda e futbollit kosovar, Fadil Vokrrit, i cili u nda nga jeta të shtunën si pasojë e një ataku kardiak. Kur po i jepej lamtumira e fundit Vokrrit, një parashutë kuqezi me një flamur ku ishte stampuar portreti i Vokrrit është ulur në tokë, për t'i dhënë lamtumirën e fundit ish-presidentit të Federatës së Futbollit të Kosovës. Një numër i lartë njerëzish nga bota e sportit, politika dhe jo vetëm ishin të pranishëm në këtë ceremoni, duke bërë që Vokrrit të përcillet për në banesën e fundit, ashtu siç i ka hije një legjende si ai.

ZV.PRESIDENTI I FIFA-s

Në homazhet e kryera për figurën e madhe të sportit në Kosovë, Fadil Vokrrit, pas ndarjes nga jeta në mënyrë të papritur, ishte prezent edhe ish-sekretari i përgjithshëm i FIFA-s, Zvonimir Boban. Ky i fundit është një legjendë e futbollit evropian, pasi ka bërë historinë edhe me klubin e Milanit, duke fituar 4 tituj kampion dhe 1 trofe në "Champions League". Në një intervistë për "Supersport", Boban ka vlerësuar fig-

Zoro Boban: Lamtumirë legjendë, do luajmë futboll në botën tjetër

urën e Vokrrit, ndërsa ka shprehur dëshirën e madhe për të luajtur futboll me të në një botë tjetër. "Erdha për ta ngushëlluar familjen e Vokrrit për këtë humbje të madhe. Më duhet të sjell ngushëllimet edhe nga Ceferin. Ka qenë legjendë e futbollit. Më rrallë jam takuar viteve të fundit, por ka qenë njeri i madh. Ai ishte edhe një futbollist i madh, mund të luante në klubet



më të njohura evropiane. Shpresoj se do të takohemi në një botë tjetër, për të luajtur futboll", ka thënë zv.sekretari i përgjithshëm i FIFA-s,

TELEGRAMI I PRESIDENTIT TË UEFA-s

Nuk mund të mungonte as reagimi i presidentit të UEFA-s, Aleksandër Ceferin, që nëpërmjet faqes zyrtare të UEFA-s ngushëlloi futbollin kosovar dhe familjen e të ndjerit. "Ne jemi të tronditur dhe shumë të pikëlluar që dëgjuam për humbjen e Fadil Vokrrit. Ai ishte një futbollist i shquar, që gëzonte një karrierë të shquar dhe u bë administrator i futbollit dhe president i shoqatës kombëtare të kalibrimit më të lartë. Fadili ishte figura


Ceferin: Jam i tronditur, Fadili figura kryesore e zhvillimit të FFK-së

kryesore në zhvillimin e futbollit të Kosovës, që i mundësoi Federatës së Futbollit të Kosovës të bëhej anëtare e UEFA-s në 2016. Që prej atëherë, ai ka udhëhequr integrimin e federatës brenda UEFA-s me aftësi dhe angazhim të madh. Në emër të futbollit evropian, dëshiroj të shpreh simpatinë më të thellë për familjen e tij, Federatën e Futbollit të Kosovës dhe komunite-



tin e futbollit të Kosovës", ka shkruar presidenti i UEFA-s, Aleksandër Ceferin.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Ooole aktor
5. Si vizuale.
11. Në fund të lutjes.
13. Janë popullsi e qytetit
14. Një pije freskuese.
17. Është enjje.
18. Teke prize.
20. Janë mallkime shkishëruese.
22. Një aftësi paranormale.
25. Janë fakultetet më me leverdi.
27. Gjëja e romakëve.
29. Thahen me bonifikim.
30. Zemeckis regjisor
33. Janë në temë
34. Inicialet e Harris aktor.
36. Është figurë gjeometrike.
37. Një markë makine qepëse.
41. Kush ka... ka zët.

42. Mbyllin komentin.
43. I bëhen të gjitha mikut.
45. Një version i dikurshëm i FIAT.
46. Fillojnë shkurt.
47. Një pikë në ligj.
48. Inicialet e Morricone-s.
49. Të fundit në manastir.
50. I ka kërcyer të xhindosurit.
51. Janë pjesë të dramës

VERTIKAL

1. Fillojnë panikun.
2. Ai i trëndafilut është i Umberto Eco-s.
3. Në krye të tenorëve.
4. Mund të jetë gjaku dhe kuzhine.
5. Inicialet e Anka këngëtar.
6. Kush ka... ka nevojë për gjak
7. Ndiqet ajo e fundit
8. Duken të gjata në pritje.
9. Një fazë gjumi.
10. Shteti i francezëve
12. Një art i shtatë.
13. Është pëllgu.

15. Shkroi Pa familje

16. Janë dokumente shtëpia.
18. Është filmi që mallëngjen.
19. Një kolegji anglez.
21. Janë baballarët.
23. Mund të jetë elektrike.
24. Është hidrofobi.
26. Ajo e forcës është për të çmendur.
27. Kremi pa ekstreme.
28. Si sezionate.
31. Mund të jenë unike
32. Mund të jenë periode të tilla.
35. Është bishë që zgërdhiet.
38. Fillojnë nazet
39. Inicialet e Diamanti aktor.
40. Është moshë më e bukur.
44. Fillojnë temën.
46. Kufizojnë një send.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Një film publicitar
5. Në krye të bashkisë .
7. Me Romeo në makinë
10. Në fund majtas
11. Janë kompozime si Vejusha gazmore
15. Janë në masë.
16. Janë melodrama.
17. Fillojnë dobët.
18. Në hyrje të radios.
19. Një pjesë e lipotimisë.
21. Është gjendje të fikti.
24. Është vërtet i mërziqshëm.
25. Maiden që këndojnë
26. Hurlley aktore.
27. Pak torturuese.
28. Ekstreme në tunel.
29. Ndezur në aparaturë.
30. Ai i shenjtë është pa.
31. Merrte fuqi nga toka.

32. Pak enigmatike.

33. Ngryset në mbrëmje.
35. Kufij itinerari.
36. Ai i harrësës ishte Leti.
39. Është porosia e fundit.
41. Janë bimë uji.
42. Opera e Mascagni-t.
44. Magjritë piktor.
46. Është ndenjëse zburkuri.
48. Ndiqen me ilaçe.
50. Në krye të armiqve.
51. Një godinë në miniaturë
52. Është muzika... më e kollajtë.


VERTIKAL

1. Qe mbreti i parë i Izraelit.
2. Post scriptum
3. Një sferë... për model.




4. Është infeksion në bark
5. Një mund të jetë bark
6. Në krye të atletëve.
7. Është grimcë me bërthamë.
8. Ishte sundimtar si Tutankamon
9. Masat pa kufij
12. Një sport baskësh .
13. Janë marrëdhënie.
14. Padia pa kufij.
16. Është në minorancë.
20. I ka shumë të goditura Agron Llakaj.
22. Kështu janë lojtarë të formaconit
23. Janë të holla dhe therëse.
26. Makinë nuse.
32. Është dita e dytë
34. Bisha aktore.
37. Në mes të rrugës.
38. Një trup pa kënde.
40. Satie kompozitor.
43. I ka të ndryshme një sakat.
45. King Cole i muzikës.
46. Inicialet e Penn aktor.
47. Në mes të dhomës.
49. Të fundit në spital.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

7	6			9	1			
		5			4	7		
2		4	1		8			9
								2
			6					
	8	7	2			6		
	9	3				8		
			1		4			
7		8	5					

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	5	2	4	7	8	3	6	1
1	8	6	9	5	3	2	4	7
7	3	4	1	6	2	5	8	9
3	9	5	6	8	1	4	7	2
4	6	8	5	2	7	9	1	3
2	7	1	3	9	4	6	5	8
5	1	7	2	3	6	8	9	4
6	4	3	8	1	9	7	2	5
8	2	9	7	4	5	1	3	6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Paraja mund të blejë shtratën, por jo gjumin. Libra, por jo arsimit. Rroba të bukura, por jo finesës. Argëtim, por jo lumturi. Njerëz, por jo njerëzimin.

- "Një përfaqim i heshtur, është sa një mijë fjalë për një zemër të lëndur"

- Zemra ka veshët e saj për të dëgjuar atë që mendja nuk e kupton.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

7	15	3	6		4	6		6	1	4	1	7	T	R	I	M	S	M	M	A	S	A	T	
1	15		11	8		8	6		5	L	I	M	I	A	A	R	B	E	E	M	L	I	M	A
17		14	8	5	8	12	1	7	8	7		5	K	D	E	L	E	G	A	T	E	T	L	
	6	3	7	9	6	1	13	8	7		14	8		M	I	T	O	M	A	N	E	T	D	E
17	9	6	19	13	3	7	3	7	3	7		13	K	O	M	U	N	I	T	E	T	E	T	N
9	16	8	15	1	7	9	15	8	7		7	7	O	P	E	R	A	T	O	R	E	T	F	T
6		13	3	8	8	13	9			12	1		M	N	I	E	N	O	G	A				
16		4	13	13	3		6	1	5	5	3		P	S	N	N	I	M	A	L	L	I		
1	6	3	1	13	7		17			9	4	8	A	M	I	A	N	T	K	O	S	E		
15		9	7		8	17	3	16	9	15	8		N	O	T	E	K	I	P	O	R	E		
3	7	15		8	7	3	5	8	13	3		8	I	T	N	E	T	I	L	E	N	I	E	
1	5	3	11	3		4	3	15	7	1	17	3	A	L	I	B	I	S	I	R	T	A	R	I

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



Thënie të mënçura

- - Statistikat thonë se një në katër njerëz vuajnë nga një çrregullim mendor.
- Mendoni për tre miqtë tuaj më të mirë.
- Nëse ata janë të shëndetshëm, atëherë ju keni një problem.
- - Nuk e ka fajin pasqyra ... në qoftë se hunda juaj është e shtrembër.
- - Kur jeni të sigurt që keni të drejtë, nuk ka nevojë për të diskutuar me ata që janë gabim.

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

